

B a n k a e S h q i p ë r i s ë

RAPORTI VJETOR
I MBIKËQYRJES

2 0 0 5

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë.

Tel: 355-4-222230; 235568; 235569;

Faks: 355-4-223558

e-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:

Spektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit.

E-mail: public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.

Tirazhi: 1000 kopje

P Ë R M B A J T J A

MISIONI I MBIKËQYRJES	7
A- MBIKËQYRJA GJATË VITIT 2005	8
1. Ndryshimet dhe zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullativ	8
2. Mbikëqyrja në vend	12
B. GJENDJA FINANCIARE E SISTEMIT BANKAR NË VITIN 2005	17
1. Mjedisi ekonomik në vitin 2005	17
2. Struktura e sistemit bankar shqiptar	21
3. Administrimi i rreziqeve në veprimtarinë bankare	28
4. Mjaftueshmëria e kapitalit	33
5. Treguesit e rentabilitetit	35
C. INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA	37
1. Aktiviteti i institucioneve financiare jobanka në Shqipëri	37
2. Kuadri rregullativ i institucioneve financiare jobanka në Shqipëri	38
3. Mbikëqyrja e institucioneve financiare jobanka	38
4. Analizë për periudhën mars - dhjetor 2005	39
DISA INFORMACIONE MBI AKORDIN E RI TË BAZELIT (BAZEL II) DHE MUNDËSINË E IMPLEMENTIMIT TË TIJ NË SHQIPËRI	41
1. Akordi ekzistues i Bazelit për kapitalin. Pse lindi nevoja për një Akord të Ri?	41
2. Bazel II, kundrejt Akordit të 1988-s	42
3. Zbatimi i Bazel II në vendet në zhvillim dhe ndikimet e tij (të përgjithshme)	43
Aneks 1. Struktura e Departamentit të Mbikëqyrjes (datë 31 dhjetor 2005)	46
Aneks 2. Niveli i aktiveve, i depozitave dhe i kredive në dhjetor 2005 (milionë lekë)	47
Aneks 3. Numri i degëve, i agjencive dhe i punonjësve për çdo bankë	47
Aneks 4. Aktivitet dhe pasivet e sistemit bankar (dhjetor 2005)	48
Aneks 5. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë	49
Aneks 6. lista e rregulloreve të Mbikëqyrjes Bankare në fuqi, deri në fund të vitit 2005	61
Shënime	63

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

Tabelë 1.	Lista e subjekteve të licencuara.	22
Tabelë 2.	Mbulimi me shërbime bankare.	25
Tabelë 3.	Indeksi H (Herfindahl) i përqëndrimit të aktiveve dhe depozitave.	26
Tabelë 4.	Struktura e tepricës së kredisë sipas afatit.	29
Tabelë 5.	Klasifikimi i kredisë në përqindje ndaj tepricës së kredisë.	30
Tabelë 6.	Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave.	30
Tabelë 7.	Ecuria e raportit të aktiveve afatshkurtra ndaj pasiveve afatshkurtra për sistemin bankar në vite.	31
Tabelë 8.	Struktura e kapitalit aksioner.	33
Tabelë 9.	Ecuria e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut për sistemin bankar në vite.	34
Tabelë 10.	Ecuria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave në vite.	35
Tabelë 11.	Ecuria e elementeve kryesore të rezultatit neto (jo kumulative) në milionë lekë.	35
Tabelë 12.	Tregues kryesorë të rentabilitetit në përqindje.	36
Tabelë 13.	Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje.	36
Tabelë 14.	Tregues të rentabilitetit në milionë lekë.	37
Tabelë 15.	Treguesi i efikasitetit (jo kumulative) në milionë lekë.	37
Tabelë 16.	Aktivet e IFJB-ve e SHKK-ve.	39
Tabelë 17.	Cilësia e aktiveve (dhjetor'05).	40
Tabelë 1.	Matrica e ponderimeve të pretendimeve ndaj sovranit, bankave dhe korporatave.	44

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

Grafik 1. Struktura e pronësisë së kapitalit të sistemit bankar, në vite.	23
Grafik 2. Struktura e pronësisë së kapitalit sipas grupbankave.	23
Grafik 3. Struktura e totalit të aktiveve të sistemit bankar sipas pronësisë.	23
Grafik 4. Numri i degëve/agjencive (në përqindje) sipas grupbankave.	24
Grafik 5. Numri i punonjësve (në përqindje) sipas grupbankave.	24
Grafik 6. Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.	27
Grafik 7. Struktura e aktiveve.	28
Grafik 8. Struktura e pasiveve.	28
Grafik 9. Teprica e kredisë bruto, ecuria tremujore kumulative (në miliardë lekë).	28
Grafik 10. Kredia e re e akorduar nga sistemi bankar (në miliardë lekë).	29
Grafik 11. Peshat e grupbankave në totalin e tepricës së kredisë së sistemit bankar (në %).	29

MISIONI I MBIKËQYRJES

Mbikëqyrja ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” nr. 8269, datë 23.12.1997 dhe të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” nr. 8365, datë 02.07.1998.

MISIONI I MBIKËQYRJES

Banka e Shqipërisë, në zbatim të përgjegjësive ligjore si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera, që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj, ka për qëllim që:

- të sigurojë veprimtari të shëndoshë bankare në harmoni të plotë me / dhe në zbatim të kuadrit ligjor e rregullativ përkatës, me qëllim parandalimin e krizave financiare dhe mbrojtjen e depozituesve;
- të ruajë stabilitetin e sistemit bankar dhe më gjerë, duke monitoruar zhvillimet e tregut dhe duke rekomanduar masat e nevojshme, në mënyrë që bankat t’iu përshtaten këtyre zhvillimeve dhe të administrohen në vazhdimësi sipas parimeve më të mira;
- të forcojë besimin e publikut tek sistemi bankar si edhe të nxisë disiplinën e tregut, duke kërkuar rritjen e transparencës së sistemit bankar;
- të ndikojë në zhvillimin e një konkurrence të ndershme në sistemin bankar dhe më gjerë, dhe të sigurojë trajtimin e barabartë të subjekteve të licencuara dhe të klientëve të tyre;
- të ofrojë një komunikim të vazhdueshëm profesional ndaj operatorëve të tregut financiar si edhe ndaj institucioneve të tjera që ndikojnë në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmirësimit të funksionimit të tregut financiar dhe të operatorëve të tij.

Banka e Shqipërisë, do të realizojë funksionin e saj mbikëqyrës, nëpërmjet:

- a) ndërtimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, në mënyrë që ai të jetë në harmoni me parimet më të mira ndërkombëtare dhe i zbatueshëm në praktikë;
- b) inspektimeve në vend dhe analizës së treguesve të institucioneve të licencuara, si edhe ndërmarrjes së veprimeve korrektuese për zgjidhjen

- e problemeve të ndryshme;
- c) orientimit të procesit mbikëqyrës drejt identifikimit të rrezikut me të cilin ndeshen institucionet e licencuara, duke rekomanduar zgjidhjet përkatëse;
- d) ndërtimit të politikave, të cilat synojnë orientimin e sistemit bankar drejt zhvillimeve të dëshiruara;
- e) bashkëpunimit me institucionet financiare që mbikëqyren, me institucione të tjera financiare brenda vendit si edhe me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera;
- f) përmirësimit të vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse.

Në zbatimin e kërkesave të funksionit mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë do të synojë nivelet më të larta të integritetit, të profesionalizmit, të eficiencës dhe të transparencës.

A- MBIKËQYRJA GJATË VITIT 2005

1. NDRYSHIMET DHE ZHVILLIMET NË KUADRIN LIGJOR DHE RREGULLATIV

Gjatë vitit 2005, u kryen ndryshime të kuadrit rregullativ mbikëqyrës, me qëllim plotësimin e tij dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare. Ndryshimet kryesore ishin:

1- Me vendimin nr.03, datë 26.01.2005 u miratua rritja e nivelit minimal të kapitalit të kërkuar dhe të paguar për hapjen e një banke nga 700 milionë lekë në 1 miliard lekë, duke ndryshuar rregulloren “Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.

Ndryshimi u diktua nga domosdoshmëria e rritjes së sigurisë për institucionet që kërkojnë të licencohen si bankë, në kushtet e rritjes së konkurrencës në tregun bankar. Vendimi i mësipërm i Këshillit Mbikëqyrës u shoqërua me një vendim të dytë¹ i cili kishte për qëllim caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar për bankat ekzistuese. Ky element është i rëndësishëm për ruajtjen e ekuilibrave në treg ndërmjet bankave të reja që licencohen rishtaz dhe bankave ekzistuese që veprojnë në të. Për të gjitha bankat që licencohen pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, kapitali minimal i kërkuar është 1 miliard lekë, ndërsa për bankat ekzistuese plotësimi i nivelit të ri të kërkuar, duhet të bëhet brenda një periudhe trevjeçare sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim.

2- Me vendimin nr. 32, datë 27.04.2005, Këshilli Mbikëqyrës miratoi “Sistemin raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”. Hartimi i sistemit raportues për subjektet jobanka ka për qëllim përafrimin e tij me standardet ndërkombëtare të raportimit për plotësimin e kërkesave të mbikëqyrjes dhe të politikës monetare. Ky vendim u shoqërua edhe me

ndryshimet përkatëse në rregulloren “Për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka”² ku përcaktohet detyrimi i raportimit në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të miratuar, jo më vonë se 40 ditë pas mbylljes së tremujorit.

3- Gjatë këtij viti u bënë disa ndryshime edhe në udhëzimin “Për kapitalin rregullator”³. Ndryshimet synojnë saktësimin e konceptit të fitimit ushtrimor të fundit të vitit, nisur nga përvoja e zbatimit të këtij udhëzimi, si edhe saktësimin në formularin e raportimit të pjesës përkatëse zbritëse të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara nga kapitali rregullator.

4- Ndryshimi në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit” u bë me qëllim saktësimin e listës së vendeve të OECD. Njëkohësisht, ndryshimet kanë përfshirë edhe ponderimin mbi baza neto të disa zërave jashtë bilancit të garantuar me kolateral cash.

5- Ndryshimi në rregulloren “Për licencimin e subjekteve jobanka” kishte për qëllim përputhjen e këtij akti nënligjor rregullativ, të nxjerrë nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me ligjin nr.9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përjashtuar nga perimetri i licencimit dhe mbikëqyrjes shoqëritë që ushtrojnë vetëm veprimtarinë e qirasë financiare.

Disa nga aktet rregullative të reja janë:

1- Rregullorja “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, e cila plotëson kuadrin rregullativ të mbikëqyrjes bankare dhe është ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare dhe rregullave për realizimin e mbikëqyrjes së konsoliduar. Ajo përmban dy pjesë: pjesa e parë, përcakton fushën e zbatimit të mbikëqyrjes së konsoliduar dhe pjesa e dytë, instrumentet për realizimin e mbikëqyrjes së konsoliduar, ku përfshihen marrëveshjet e bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe/ose autoritetet vendimmarrëse e drejtuese të grupit të konsoliduar. Rregullorja përbëhet nga tre shtylla kryesore a- kontabiliteti i konsoliduar, b- mbikëqyrja sasiore dhe c- mbikëqyrja cilësore.

Mbikëqyrja e konsoliduar është një element thelbësor i mbikëqyrjes, veçanërisht asaj bankare. Në terma më të thjeshtë, ajo është një përgjigje ndaj faktit që bankat shpesh drejtojnë pjesë të veprimtarive të tyre – në disa raste pjesën kryesore – përmes filialeve dhe pjesëmarrjeve. Kjo përqsasje e mbikëqyrjes, vlerëson fuqitë e një grupi si një të tërë, duke marrë parasysh të gjitha rreziqet që mund të ndikojnë në një bankë, pavarësisht nëse këto rreziqe janë në librat e bankës ose të enteve të lidhura me të si anëtare të të njëjtit grup. Një bankë e cila në vetvete është një filial brenda një grupi biznesi më të gjerë, mund të ekspozohet ndaj rreziqeve, që vijnë si rezultat i veprimtarive të pronarëve të saj ose nga entitetet “paralele” brenda grupit. Për këto arsye, mbikëqyrësit duhet të monitorojnë bankat mbi baza të konsoliduara, një kërkesë kjo e detyrueshme për të gjitha autoritetet mbikëqyrëse dhe bankat që veprojnë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), si edhe në vende të tjera të zhvilluara si Australi, Kanada, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mbikëqyrja e konsoliduar është një element plotësues i mbikëqyrjes së bankave mbi baza “solo” dhe shpesh mbikëqyrësit mund të aplikojnë të njëjtat teknika të vlerësimeve financiare dhe të rregullimeve, si mbi baza të konsoliduara ashtu edhe jo të konsoliduara.

2- Udhëzimi “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve të punës së subjekteve që licencohen nga Banka e Shqipërisë”. Ky udhëzim u hartua me qëllim që të plotësohet një mungesë rregullative, lidhur me kushtet minimale që duhet të plotësojnë subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë në drejtim të sigurisë teknike, në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Këto kushte minimale, lidhen me nevojën që subjektet të disponojnë procedura të miratuara për mbrojtjen e paprekshmërisë fizike të objekteve, të mjediseve, të sistemeve informatike që përdorin dhe si t’i zbatojnë këto procedura në praktikë. Njëkohësisht, në udhëzim janë parashikuar disa kërkesa lidhur me konfigurimin e mjediseve të bankës ku ndërveprohet me klientët, ku administrohen vlerat monetare fizike, si dhe lidhur me mënyrën se si do të bëhet monitorimi i këtyre mjediseve nga këndvështrimi i sigurisë. Aktualisht, bankat e nivelit të dytë zbatojnë mjaft nga këto kërkesa të diktuar nga praktika bankare, kërkesat e bankës-mëmë etj.. Këto kërkesa do të jenë pjesë e procesit të licencimit të subjekteve të reja, si edhe në rastet kur ato dëshirojnë të zgjerojnë rrjetin e tyre me degë, me agjenci apo kur ndryshojnë adresë.

3- Rregullorja “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”. Kjo rregullore miratohet në momentin kur transaksionet bankare që kryhen në rrugë elektronike po bëhen një veprimtari normale e bankave. Qëllimi i miratimit të saj është rritja e sigurisë në kryerjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike dhe për ruajtjen e bazës së të dhënave që përdorin bankat. Këto trajtohen si nga cilësia e softeve informatike të përdorura në transaksionet bankare që kryhen në rrugë elektronike, ashtu edhe nga aftësitë e burimeve njerëzore që mbulojnë këto transaksione.

Bankingu elektronik është një term përmbledhës për procesin në të cilin klienti mund të kryejë transaksionet bankare, duke përdorur rrugën elektronike, pa qenë e nevojshme të paraqitet fizikisht në institucion. Veprimet në këtë rast mund të kryhen nëpërmjet kompjuterit personal dhe një rrjeti të dedikuar, internetit, telefonit. Zhvillimi i shpejtë i bankikut elektronik mbart në vetvete rrezik si dhe përfitime. Komiteti i Bazelit për mbikëqyrjen bankare kërkon që ky rrezik të njihet, të adresohet dhe të administrohet nga institucionet bankare në një mënyrë të kujdesshme, duke marrë në konsideratë karakteristikat e veçanta të tij, të cilat lidhen kryesisht me shpejtësinë mjaft të madhe të zhvillimit të teknologjisë dhe shërbimit të klientit, praninë kudo të tij dhe natyrën globale të rrjeteve elektronike. Përmirësimi i vazhdueshëm teknologjik dhe konkurrenca midis institucioneve bankare, kanë lejuar që të ofrohet një grup më i gjerë produktesh dhe shërbimesh bankare për klientët nëpërmjet kanaleve të shpërndarjes elektronike. Veprimi nëpërmjet këtyre kanaleve elektronike evidenton forma të reja të shfaqjes së disa rreziqeve tradicionale që lidhen me veprimtarinë bankare, veçanërisht rreziqet strategjike, operacionale, ligjore dhe të reputacionit, duke ndikuar në profilin tërësor të rrezikut të bankës.

Për të lehtësuar këto zhvillime, Komiteti i Bazelit, ka identifikuar katërmbëdhjetë parime për administrimin e rrezikut për bankingun elektronik, për të ndihmuar institucionet mbikëqyrëse dhe ato zbatuese që të shtrijnë politikat dhe proceset e tyre ekzistuese të mbikëqyrjes së rrezikut për mbulimin edhe të kësaj veprimtarie. Këto parime janë mbajtur parasysht dhe janë pasqyruar në këtë rregullore, e cila është konceptuar në këto pjesë: a) kushtet organizative, kushtet që lidhen me personelin dhe ato teknike për realizimin e shërbimit bankar në rrugë elektronike; b) kërkesat për dhënien e autorizimit nga Banka e Shqipërisë për veprimtarinë *e-banking*; si edhe c) parimet e administrimit të rrezikut të veprimtarisë *e-banking*. Për vetë veçoritë e kësaj veprimtarie, parashikohet plotësimi i disa kërkesave paraprake nga banka që lidhen me kushtet teknike, personelin, kontrollin e këtij aktiviteti, listën e transaksioneve, instrumentet, kontratat me shoqëritë mbështetëse të informatikës etj..

4- Miratimi i rregullores “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre”. Kjo rregullore është një rishikim tërësor i rregullores së mëparshme, duke marrë në konsideratë zhvillimet e reja në sektorin e mikrofinancës. Shoqëritë e kursim-kreditit po ofrojnë produkte dhe shërbime të vërteta bankare për atë pjesë të popullsisë me të ardhura relativisht të vogla apo që është vendosur kryesisht në zonat rurale, ku shërbimet e drejtpërdrejta bankare ende nuk mbërrijnë.

Një ndër ndryshimet më të rëndësishme të këtij rishikimi është mundësia e re që iu jepet shoqërive për të dhënë kredi në monedha te huaja, duke iu krijuar kështu mundësi më të mira për të shfrytëzuar burime shtesë për financim si nëpërmjet anëtarëve të tyre (me lidhje emigracioni) dhe nëpërmjet donacioneve apo kredive me terma të buta ose tregtare nga subjekte të huaja. Kjo rregullore parasheh gjithashtu edhe rishikimin dinamik të politikave kredituese pa cënuar cilësinë e portofolit, duke pranuar rast pas rasti dhe ristrukturimin e kredisë. Rregullorja bën të mundur që ShKK-të dhe unionet e tyre të monitorojnë rrezikun e veprimeve në valutë në kufij individualë për çdo valutë dhe në tërësi, për të gjitha valutat.

Rishikimi i rregullores “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre” mundësoi rishikimin e sistemit raportues, në përshtatje me përmbajtjen e re të rregullores. Sistemi përshtatet jo vetëm me standardet e raportimit, por i shërben dhe qëllimeve të analizës financiare dhe mbikëqyrëse të shoqërive. Kjo rregullore u përgatit edhe me asistencën teknike të huaj.

5- Gjithashtu, me vendimin nr.87, datë 16.11.2005, Këshilli Mbikëqyrës shfuqizoi vendimin nr.26, datë 29.03.2000 të tij mbi “Përrjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” në bazë të nenit 1, pika 2 e këtij ligji”. Shfuqizimi i këtij vendimi bën të mundur që subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë veprimtarinë e kredidhënies dhe që janë përjashtuar nga ky vendim, do t’u nënshtrohen procedurave për marrjen e licencës në përputhje me rregulloren “Për licencimin e subjekteve jobanka”.

2. MBIKËQYRJA NË VEND

Banka e Shqipërisë, bazuar në përgjegjësitë ligjore si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera si institucionet financiare jo-banka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe zyrat e këmbimit valutor, që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj, edhe gjatë vitit 2005, nëpërmjet mbikëqyrjes nga jashtë dhe inspektimeve në vend, është përpjekur të sigurojë një veprimtari të shëndoshë bankare duke ruajtur stabilitetin e sistemit bankar dhe duke forcuar besimin e publikut tek sistemi bankar.

Në vitin 2005, procesi mbikëqyrës ka pësuar përmirësime të vazhdueshme duke u orientuar sipas rrezikut të institucioneve të veçanta. Kështu, vëmendje i është kushtuar bankave dhe subjekteve jobanka, me profil më të lartë rreziku. Kjo vëmendje është kushtëzuar nga forcimi i kushteve të konkurrencës në treg. Rritja e ndjeshme e kredidhënies nga bankat, bëri që të forcoheshin kërkesat për një analizë më cilësore të klientëve kredimarrës. Si pasojë e rritjes së ndjeshme të portofolit të kredisë në veçanti, dhe e rritjes së konkurrencës në përgjithësi në sistemin bankar, janë ndjekur me kujdes efektet që kanë sjellë këto në mjaftueshmërinë e kapitalit, në normat e interesit, në kursin e këmbimit, në forcimin e sistemeve të kontrollit të bankave të nivelit të dytë, duke bërë rekomandime për ruajtjen e mirëkapitalizimit të veprimtarisë, forcimin e strukturave drejtuese, të sistemeve të kontrollit dhe të analizës së brendshme, për përmirësime në sistemet e teknologjisë së informacionit etj..

Procesi i mbikëqyrjes gjatë vitit 2005 është përmirësuar edhe në aspektin e komunikimit me strukturat drejtuese të bankave. Kështu, gjatë vitit 2005 janë realizuar mjaft takime me këshillat drejtues të bankave, komitetet e kontrollit si dhe me drejtuesit ekzekutivë të tyre. Në shumicën e këtyre takimeve janë përgatitur prezantime të veçanta për situatën e bankës "nga këndvështrimi mbikëqyrës".

Gjithashtu gjatë vitit 2005, një vëmendje më e madhe i është kushtuar bashkëpunimit me Autoritetet Mbikëqyrëse të vendeve nga të cilat vijjnë investimet e huaja në Shqipëri si dhe të vendeve të rajonit. Kështu, janë zhvilluar takime me Autoritetin e Pagesave të Kosovës, janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Maqedonisë dhe me Bankën Qendrore të Malit të Zi dhe janë shkëmbyer informacionet e përgjithshme mbi përbërjen e sistemit bankar, janë vendosur kontakte pune dhe është shkëmbyer informacion me Bankën e Italisë, si edhe ka filluar një bashkëpunim mjaft i frytshëm me Autoritetin Mbikëqyrës të Tregut Financiar në Austri. Po kështu, janë ripërtërirë marrëdhëniet me Bankën e Greqisë, me Autoritetin Mbikëqyrës në Turqi dhe me Bankën Kombëtare të Bullgarisë.

Gjatë vitit 2005 sistem i vlerësimit të bankave ka qenë sistemi CAMELS. Bazuar në këtë sistem është bërë vlerësimi i kapitalit, i cilësisë së aktiveve, i administrimit, i të ardhurave, i likuiditetit, i ndjeshmërisë ndaj rreziqeve të tregut si dhe vlerësimi i përgjithshëm i bankave. Mbështetur në sistemin e mësipërm të vlerësimit, gjendja e përgjithshme e sistemit bankar gjatë vitit 2005 vlerësohet pothuaj në të njëjtin nivel me renditjen e përgjithshme të

vitit 2004. Nga elementet CAMELS që kanë ndryshuar në kahun negativ të vlerësimit gjatë vitit 2005 janë "kapitali" dhe cilësia e aktiveve. Gjithsesi, siç është theksuar dhe më sipër gjatë vitit 2005, është rritur kërkesa për një mbikëqyrje efektive të orientuar drejt rreziqeve, duke i identifikuar dhe duke marrë masa korigjuese për përmirësimin e tyre.

Gjatë vitit 2005 janë kryer këto inspektime:

Bankat	15 inspektime të plota
	14 inspektime të pjesshme
Institucionet jobanka	7 inspektime të plota
	7 inspektime të pjesshme
Shoqëritë e kursim-kreditit	2 inspektime të plota
	2 inspektime të pjesshme
Zyrat e këmbimit valutor	41 inspektime

2.1 BANKAT

Gjatë vitit 2005 janë kryer 29 inspektime në banka (të plota dhe të pjesshme) pa përfshirë këtu inspektimet e bëra për verifikimin e kushteve teknike për zhvillimin e veprimtarive bankare në mjediset e degëve dhe të agjencive të reja të bankave si dhe inspektimet e bëra për ankesa të klientëve ose kërkesa të tjera. Objektivi kryesor ka qenë që të sigurohet një veprimtari e shëndoshë dhe e sigurtë e bankave dhe e subjekteve jobanka. Në funksion të këtij qëllimi, kanë qenë dhe rekomandimet e Bankës së Shqipërisë.

Probleme të evidentuara nga inspektimet e plota

Problemet e konstatuara nga ekzaminimet në vend mund t'i ndajmë si më poshtë:

Probleme që lidhen me strukturat e drejtimit të lartë (këshilli drejtues dhe komiteti i kontrollit). Në këtë drejtim, rekomandimet e inspektimeve kanë synuar rritjen e përgjegjësisë dhe të vëmendjes së këtyre organeve ndaj çështjeve, të cilat janë gjykuar kritike për të siguruar një aktivitet të shëndoshë dhe të sigurtë të bankave. Rekomandimet kanë synuar gjithashtu plotësimin e bankave me politika dhe procedura të mjaftueshme për një veprimtari të sigurtë, eliminimin e konfuzionit apo ngadalësisë së vendimmarrjes nga strukturat drejtuese, vendosjen e raporteve të drejta me strukturat e bankave-mëma etj.. Për komitetet e kontrollit të bankave, është kërkuar rritja e pranisë së tyre në banka, bashkëpunimi më i ngushtë me kontrollin e brendshëm, rritja e përgjegjësisë për problemet e prezantuara etj.. Rekomandimet kanë përfshirë edhe respektimin e kërkesave për plotësimin në kohë të dokumentacionit të

drejtuesve të lartë, të cilët duhet të marrin miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë. Shpesh ky dokumentacion dërgohet me vonesë. Organet drejtuese të bankave në përgjithësi, kanë reaguar pozitivisht ndaj rekomandimeve. Në funksion të rritjes së bashkëpunimit midis tyre dhe Bankës së Shqipërisë, siç është theksuar dhe më sipër, janë shtuar takimet dhe kontaktet midis të dyja palëve.

Probleme që lidhen me kuadrin e brendshëm rregullativ të bankave. Me zgjerimin e aktivitetit dhe rritjen e kompleksitetit të shërbimeve bankare, lind nevoja për pasurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit të brendshëm rregullativ. Ky problem është më i prekshëm për bankat e reja, prandaj atyre iu është kushtuar kujdes i veçantë nëpërmjet inspektimeve më të shpeshta, për të vlerësuar plotësimin e politikave dhe të procedurave të brendshme, si dhe për të verifikuar cilësinë e tyre. Edhe në këtë drejtim, bankat në përgjithësi kanë reaguar mirë, por është e nevojshme që politikatat dhe rregulloret e brendshme të jenë të miratuara në kohën e duhur nga këshillat drejtues. Lidhur me zbatimin e kuadrit të brendshëm rregullativ, vihen re shmangie nga disa banka. Në këtë kuadër është rekomanduar rritja e përgjegjësisë dhe e anës cilësore të punës së kontrollit të brendshëm dhe të komitetit të kontrollit.

Probleme që lidhen me zbatimin e rregulloreve. Megjithëse ka patur përpjekje nga bankat për një zbatim sa më të mirë të kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë, përsëri janë konstatuar raste të moszbatimeve të rregulloreve apo shkelje të kufijve të përcaktuar në to, e në disa raste edhe përsëritje të shkeljeve. Rregulloret për të cilat vihen re më tepër shkelje:

- a Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë”. Klasifikimi i kredive dhe shtesa e provigjoneve për kreditë e riklasifikuara, kanë qenë nga çështjet e ndeshura më shpesh gjatë inspektimeve të kryera. Analiza më të thella financiare të kredimarrësve, vizitat në vend, plotësimi i dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm janë disa nga rekomandimet për procesin kreditues të bankave.
- b Rregullorja “Për pozicionet e hapura valutore”.
- c Rregullorja “Për kontrollin e rreziqeve të mëdha”. Tejkalimet e kufijve të përqëndrimit për një përfitues vihen re kryesisht për vendosjet në banka (sidomos për degët e bankave të huaja) dhe disa kredimarrës.
- d Rregullorja “Për veprimtarinë valutore”. Vërejtjet për zbatimin e kësaj rregulloreje lidhen kryesisht me identifikimin e saktë të qëllimit të transfertave dhe dokumentimin e transfertave tregtare me anë të akt zhdoganimeve. Në mjaft banka është rekomanduar trainimi i personelit me formatet dhe elementet e vlefshmërisë së aktzhdoganimeve, që pranohen si dokumente justifikuese për transfertat tregtare.
- e Rregullorja “Për parandalimin e pastrimit të parave”. Zbatimi me korrektësi i kërkesave të kësaj rregulloreje për caktimin e personave përgjegjës në bankë për parandalimin e pastrimit të parave, në drejtim të identifikimit të klientëve dhe raportimit të transaksioneve sipas kufijve të caktuar, identifikimit dhe raportimit të transaksioneve të dyshimta, si edhe trainimit të personelit për parandalimin e pastrimit të parave.

Probleme që lidhen me sistemin e teknologjisë dhe informacionit. Gjatë vitit 2005, falë dhe trainimeve të bëra me specialistë norvegjezë dhe përvojës së re të marrë nga këta specialistë, u realizua përmirësimi i procedurave të inspektimit në vend për sistemin e teknologjisë së informacionit. Inspektimet e kryera sipas kësaj metodologjie të re, evidentuan probleme pothuaj në çdo bankë, të cilat lidheshin kryesisht me mungesën e strategjive të plota në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe me hartimin e procedurave për zbatimin e kësaj strategjie. Gjithashtu, duhet bërë vlerësimi i rrezikut të teknologjisë dhe informacionit dhe dokumentimit të tij, krijimi i strukturave organizative të nevojshme për sigurimin e cilësisë së teknologjisë dhe informacionit dhe auditimin e saj, hartimi i planit të rekuperimit në raste fatkeqësish, gjenerimi automatik i informacioneve të nevojshme, futja e moduleve të specializuara për fushat e ndryshme të veprimtarisë, ndarja e të drejtave lidhur me hedhjen e të dhënave dhe autorizimet e veprimeve në sisteme etj..

Në raportet e inspektimeve të këtij viti, u vlerësua reagimi i bankave lidhur me rekomandimet e dhëna, por konstatohet që reagimi mbetet i ngadaltë, edhe për shkak të kostove relativisht të larta që shoqërojnë ndryshimet e nevojshme në këto sisteme.

Probleme që lidhen me kontabilitetin. Problemet që kanë të bëjnë me zbatimin e manualit të kontabilitetit bankar, burojnë nga fakti që bankat janë lejuar të mbajnë kapitalin në monedhë të huaj. Disa nga bankat vazhdojnë të mbajnë fitimin dhe aktivet e qëndrueshme në monedhë të huaj, në kundërshtim me manualin e kontabilitetit bankar. Zgjidhja e këtij problemi do të gjykohej në përputhje me përcaktimet ligjore që mban ligji i ri për kontabilitetin.

Probleme të tjera. Probleme të tjera të evidentuara gjatë inspektimeve kanë të bëjnë me përsosjen në drejtim të arritjes së objektivave të vendosur në plan buxhetet, shtimin e personelit dhe trainimin e tij, përmirësimet në pagat e punonjësve, rrjedhjet e personelit në disa banka etj..

Inspektimet e pjeshme

Inspektimet e pjeshme kanë patur si qëllim:

Vlerësimin e realizimit të rekomandimeve të inspektimeve të plota. Gjatë vitit 2005 janë kryer mjaft inspektime të pjeshme për verifikimin e realizimit të rekomandimeve të inspektimeve të plota nga ku ka rezultuar se bankat, subjektet jobanka apo shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, kanë reaguar përgjithësisht pozitivisht ndaj këtyre rekomandimeve.

Vlerësimi i cilësisë së portofolit të kredisë. Në muajin tetor 2005 u zhvillua një inspektim horizontal në tetë bankat që kanë peshën më të madhe të kredisë në sistem, për të vlerësuar politikat dhe procedurat, organizimin, analizimin, monitorimin, kontrollin e brendshëm dhe cilësinë e portofolit të kredisë, material që iu prezantua dhe Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Nga ky inspektim, rezultoi se bankat duhet të përmirësojnë politikat dhe

procedurat në drejtim të kredidhënies, të bëjnë një organizim më të mirë të departamenteve të kredisë në drejtim të analizës dhe monitorimit, të rritsin efikasitetin e punës së kontrollorit të brendshëm si dhe t'i kushtojnë më tepër vëmendje zbatimit të rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë", për klasifikimin e kredive dhe sidomos në krijimin e fondeve rezervë (të provigjoneve) për kreditë. Gjithashtu, nga këto inspektime u evidentua nevoja dhe për përmirësimin e kuadrit rregullativ dhe të Manualit të Inspektimit të Bankës së Shqipërisë.

2.2 INSTITUCIONE JOBANKA

Problematika e inspektimeve

Gjatë vitit 2005 janë inspektuar të gjitha institucionet financiare jobanka (7 institucione). Problematika e evidentuar gjatë këtyre inspektimeve paraqitet si më poshtë:

Respektimi i kuadrit rregullativ dhe raportimet. Janë konstatuar thyerje të normave të kredive me probleme (për të dyja institucionet që ofrojnë kredi), të likuiditetit dhe të kapitalit. Edhe raportimet që duhet të kryejnë këto institucione nuk janë gjithmonë të rregullta dhe në kohën e duhur. Kohët e fundit është përcaktuar formati dhe linja e raportimit. Kjo do të ndihmojë në formimin e bazës së të dhënave për çdo institucion, krahasimin dhe agregimin e tyre, ndjekjen më të mirë të raportimeve dhe identifikimin e hershëm të shkeljes së normave të mbikëqyrjes.

Probleme të veprimtarisë. Këto janë konstatuar në institucione të veçanta, si më poshtë:

- a Prania e tepricave kreditore në llogaritë e pasivit të hapura nga institucionet për klientët. Në këto raste, është kërkuar që në marrëveshjen e nënshkruar nga të dyja palët, të përcaktohet qartë qëllimi i hapjes së llogarisë (vetëm për veprimtaritë e lejuara nga licenca).
- b Prania e tepricave negative në llogaritë e klientëve (e ngjashme me kreditë "overdraft"). Në këtë rast, është kërkuar ndërprerja e menjëhershme e kësaj praktike dhe kthimi i tepricave të llogarive në gjendje zero.
- c Rënia e kapitalit nën kufirin e lejuar për të marrë licencën si rezultat i humbjeve. Është kërkuar shtimi i kapitalit në nivelin e licencës.

Probleme të sistemeve të regjistrimit të informacionit. Disa nga këto institucione, e kanë filluar veprimtarinë e tyre me nivelet bazë të kapitalit duke kryer transaksione të thjeshta. Për këto arsye, sistemet që përdorin për kontabilizimet dhe ruajtjen e informacionit janë kryesisht manuale. Me rritjen e aktivitetit dhe të aktiveve që kanë nevojë për monitorim të kujdesshëm, si dhe për të ruajtur informacionin në përputhje me kërkesat e ligjit, këto sisteme nuk i përmbushin më tej kërkesat rregullative. Në këto raste, është rekomanduar të sigurohet një sistem informacioni i përshtatshëm dhe i automatizuar, në të

cilin të regjistrohen saktësisht të gjitha veprimet dhe të gjenerohet informacioni i nevojshëm për raportime në Bankën e Shqipërisë dhe tek autoritetet e tjera. Nga ana tjetër, është e nevojshme që këto institucione të njohin më mirë dhe të zbatojnë me rigorozitet Manualin e Kontabilitetit Bankar (ato pjesë të tij që mbulojnë veprimtaritë e tyre të licencuara).

Rekomandime të tjera. Rekomandimet e tjera kanë patur si qëllim shtimin e masave për të monitoruar dhe për t'u mbrojtur nga rreziqet e aktivitetit, luftën kundër pastrimit të parave, përmirësimin e strukturës dhe kuadrit të brendshëm rregullativ, zbatimin rigoroz të rregullores "Për veprimtarinë valutore" etj..

2.3 UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

Gjatë vitit 2005 janë organizuar 2 inspektime të plota dhe 2 inspektime të pjesshme në dy unionet e shoqërive të kursim-kreditit, që grumbullojnë depozita nga anëtarët e tyre dhe ofrojnë kredi për ta. Gjatë inspektimeve u konstatua se veprimtaria e unioneve dhe e anëtarëve të tyre në përgjithësi, ishte në përputhje me ligjin dhe kuadrin rregullativ të miratuar deri tani. Për disa prej shoqërive të kursim-kreditit, të cilat kishin devijime nga normat mbikëqyrëse, u la detyrë të sillëshin në normë brenda afateve të përcaktuara. Rekomandimet e tjera kanë të bëjnë me përmirësimin e strukturave dhe kuadrit të brendshëm, futjen e sistemeve informatike për përmirësimin e punës në të ardhmen. Nga inspektimet rezulton se organet drejtuese të të dyja unioneve "Unionit Shqiptar Kursim-Kredi" dhe unionit "Jehona", kanë patur angazhimin e duhur për realizimin e rekomandimeve të dhëna.

2.4 ZYRAT E KËMBIMEVE VALUTORE

Në fund të vitit 2005 kishte 57 zyra të licencuara të këmbimeve valutore, 7 prej të cilave u licencuan gjatë vitit. Janë inspektuar rreth 41 zyra të këmbimit valutore dhe ndër problemet kryesore të evidentuara mund të përmendim: mosmbajtjen e kontabilitetit në përputhje me ligjin, mosruajtjen e kopjeve të faturave për çdo veprim këmbimi, raportime jo të rregullta në Bankën e Shqipërisë. Për këto probleme janë lënë rekomandimet përkatëse si dhe janë marrë masa për disa nga zyrat e këmbimit më problematike.

B. GJENDJA FINANCIARE E SISTEMIT BANKAR NË VITIN 2005

1. MJEDISI EKONOMIK NË VITIN 2005

Ekonomia botërore ka vazhduar të shënojë rritje edhe gjatë vitit 2005, ndikuar kryesisht nga zhvillimet pozitive në ekonominë amerikane dhe të vendeve aziatike, si edhe nga rritja e tregtisë botërore. Megjithatë, rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2005 ishte më e ngadaltë se në vitin 2004. Ngadalësimi i

rritjes ekonomike përfshiu pothuajse të gjitha rajonet ekonomike, ndonëse më pak në Eurozonë sesa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

- *Ekonomia e Eurozonës*

Ritmi i rritjes ekonomike për vitin 2005 vlerësohet të jetë 1.6 për qind në 25 vendet e Bashkimit Evropian dhe 1.3 për qind në Eurozonë. Norma vjetore e inflacionit të harmonizuar në muajin dhjetor ishte 2.2 për qind, duke qëndruar mbi objektivin e Bankës Qendrore Evropiane.

Ndryshimet e fundit të çmimeve të administruara dhe të taksave indirekte, rritja e ndjeshme monetare dhe ajo e kredive në kushtet e një likuiditeti të bollshëm, si dhe mundësia e efektit indirekt të rritjes së çmimit të naftës mbi zërat e tjerë të indeksit të çmimeve, mundësojnë presione potenciale inflacioniste në Eurozonë. Presione të tilla mbi stabilitetin e çmimeve të identifikuar gjatë vitit 2005, nxitën Bankën Qendrore Evropiane (BQE) të rriste me 25 pikë bazë (0.25 për qind) normën bazë të interesit, në muajin dhjetor të këtij viti, duke e çuar në 2.25 për qind. Kjo ishte edhe hera e parë që BQE ndryshonte politikën e saj monetare nga nivelet më të ulëta historike, që prej mesit të vitit 2003. Qëndrimi i politikës monetare të BQE-së konsiderohet të ketë pasur gjatë vitit 2005, një efekt pozitiv në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe në pakësimin gradual të normës së papunësisë.

Llogaria korente deri në muajin tetor, shënoi një deficit prej 9 miliardë eurosh, në krahasim me një suficit prej 43 miliardë eurosh që u regjistrua një vit më parë. Kjo zhvendosje shpjegohet me rritjen e ndjeshme në vlerën e importeve në krahasim me atë të eksporteve, të shkaktuar kryesisht nga rritja në çmimet e importeve.

- *Ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*

Ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës vlerësohet të jetë rritur edhe gjatë vitit 2005, ndonëse me ritme më të ngadalta se vitet e mëparshme. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) u rrit me 3.5 për qind nga 3.75 që ishte një vit më parë. Norma vjetore e inflacionit në muajin dhjetor shënoi 3.4 për qind, nga 3.3 për qind që ishte një vit më parë, ndërsa rritja ekonomike ka ndikuar në krijimin e vendeve të reja të punës. Norma e papunësisë në muajin dhjetor shfaqte vlerat 4.9 për qind nga 5.4 për qind që ishte një vit më parë, duke shënuar kështu një ndër nivelet më të ulëta të vendeve të zhvilluara. Ndërkohë, deficiti buxhetor për vitin 2005 vlerësohet të jetë 3.5 për qind e PBB-së.

Banka e Rezervës Federale (FED) ka vazhduar të zbatojë një politikë shtrënguese monetare edhe gjatë vitit 2005. Norma bazë e interesit është rritur 8 herë gjatë vitit 2005, duke arritur në 4.25 për qind në fund të vitit. Ekonomia amerikane ka përfituar nga nënçmimi i akumuluar i dollarit që ka ndihmuar eksportet si dhe nga rritja e vazhdueshme e produktivitetit gjatë vitit 2005. Megjithatë, ngadalësimi i rritjes ekonomike gjatë tremujorit të katërt, si pasojë e çmimeve të larta të naftës dhe e dëmeve të shkaktuara nga uraganet, ka rritur dyshimet për ruajtjen e ritmeve të njëjta të rritjes ekonomike për vitin 2006.

- *Mjedisi ekonomik në Shqipëri*

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, procesi i konsolidimit makroekonomik të ekonomisë shqiptare u reflektua në vitin 2005 në rritje ekonomike, ndërkohë që është ruajtur qëndrueshmëria makroekonomike. Kështu, gjatë vitit janë ruajtur norma të ulëta dhe të qëndrueshme të inflacionit, një bilanc pozitiv i pagesave, si dhe ndërmjetësim i mirë i aktivitetit ekonomik nga sistemi bankar. Ekonomia e vendit vlerësohet të jetë rritur me 5.5 për qind në terma realë gjatë vitit 2005, e shoqëruar me një inflacion nën kontroll rreth nivelit 3 për qind - brenda objektivit të synuar nga Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet makroekonomike gjatë vitit 2005 kanë qenë nën presionin e disa faktorëve *shock* të brendshëm dhe ndërkombëtarë. Situata e zgjatur pas zgjedhjeve politike për Kuvendin e ri, kriza energjitike që kaloi ekonomia në tremujorin e fundit të vitit, si dhe rritja që pësoi çmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare, vlerësohet të kenë ndikuar në uljen me 0.5 pikë përqindjeje të ritmit të rritjes ekonomike, krahasuar me parashikimin. Këta faktorë ndikuan gjithashtu edhe në luhatjen e likuiditetit të sistemit bankar gjatë gjashtëmujorit të dytë, dhe të normave të interesit të bonove të thesarit.

Gjatë vitit 2005 ecuria e investimeve ka qenë shumë e ngjashme me atë të vitit 2004; raporti i investimeve ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), u rrit me 0.4 pikë përqindjeje duke arritur në 24.2 për qind e duke ruajtur të njëjtin nivel mesatar të 4 viteve të fundit. Normat e ulëta të interesit kanë nxitur rritjen e investimeve, ndërsa kanë ulur stimulim për kursim, duke çuar në uljen e raportit të kursimeve ndaj PBB-së me 1.4 pikë përqindjeje, krahasuar me një vit më parë. Investimet publike dhe ato private u rritën me të njëjtën masë, prej 0.2 pikë përqindjeje gjatë vitit 2005 çka vlerësohet si një rritje e kënaqshme. Rritja e investimeve private është mbështetur edhe nga zhvillimet në sektorin financiar dhe, në veçanti, nga rritja e shpejtë e kredihënies bankare për ekonominë.

Treguesit fiskalë. Edhe gjatë vitit 2005, autoritetet fiskale kanë ndjekur një politikë buxhetore të kujdesshme, mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2005-2007. Të ardhurat buxhetore janë rritur gjatë vitit 2005, duke u realizuar në masën 97 për qind ose 8.9 për qind më shumë se një vit më parë, dhe përbëjnë 23.4 për qind të PBB-së. Përparësia e administratës ka qenë rritja e të ardhurave tatimore si përbërës kryesor i të ardhurave totale. Shpenzimet buxhetore u realizuan në masën 92 për qind ose 2.7 për qind më shumë se vitin e kaluar, dhe kishin një peshë prej 26.7 për qind mbi PBB-në. Rritja e shpenzimeve totale të këtij viti është dukshëm më e ulët se ritmi mesatar i rritjes së këtij treguesi në shtatë vitet e fundit. Deficiti buxhetor gjatë vitit 2005, pati një peshë prej 3.2 për qind mbi PBB-në dhe u zvogëlua me 27 për qind krahasuar me vitin 2004, duke shënuar uljen më të madhe të tetë viteve të fundit.

Spektori i jashtëm i ekonomisë. Gjatë vitit 2005 rritja e importeve të mallrave ka qenë më e shpejtë se rritja e eksporteve, duke çuar në thellim të deficitit tregtar. Konkretisht, çmimet e larta të naftës në tregjet ndërkombëtare dhe

rritja e aktivitetit kreditues kanë çuar në rritje të importeve me rreth 16 për qind. Për pasojë edhe deficitit korent është thelluar këtë vit e vlerësohet të ketë arritur në 5.5 për qind të PBB-së, nga niveli 3.8 për qind i PBB-së në vitin 2004. Megjithatë, flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e deficitit korent, duke mundësuar një bilanc të përgjithshëm pozitiv. Sipas statistikave të bilancit të pagesave për vitin 2005, tregtia e jashtme në shërbime u evidentua gjatë vitit 2005 si aktivitet shumë i rëndësishëm për ekonominë shqiptare.

Inflacioni. Në fund të vitit 2005, inflacioni vjetor shënoi vlerën 2.0 për qind, ndërkohë që inflacioni vjetor mesatar rezultoi 2.4 për qind, duke u luhatur rreth kufirit të poshtëm të objektivit. Inflacioni vjetor qëndroi brenda kufijve 2 – 4 për qind, gjatë pjesës më të madhe të vitit. Në mbajtjen nën kontroll të presioneve inflacioniste kanë ndikuar gjallërimi i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2005, politikat e kujdesshme makroekonomike si edhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit. Faktorët me natyrë *shock* si shtrenjtimi i çmimit të naftës dhe situata e rënduar energjitike, kanë ndikuar në rritjen inflacionit gjatë pjesës së dytë të vitit, por pa kompromentuar respektimin e objektivit të inflacionit dhe perspektivën afatgjatë të stabilitetit të çmimeve.

Politika monetare. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë përgjithësisht neutrale, gjatë vitit 2005. Norma bazë e interesit u ul vetëm një herë, në fund të tremujorit të parë, me 0.25 pikë përqindjeje dhe u mbajt e qëndrueshme në 5 për qind, për pjesën tjetër të vitit.

Burimi kryesor i zgjerimit monetar gjatë kësaj periudhe ka qenë kreditimi i ekonomisë që është rritur me ritme të larta e ka kompensuar rënien e huamarrjes së qeverisë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, Banka e Shqipërisë e ka kufizuar ndërhyrjen e saj në tregjet e parasë në tërheqjen e likuiditetit, ndërsa në gjashtëmujorin e dytë të vitit ka blerë valutë në mënyrë të vazhdueshme, duke zbutur presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit dhe duke injektuar likuiditet në treg. Ndërkohë, dinamika vjetore mbiçmuese e lekut, veçanërisht mbiçmimi i lekut ndaj euros, dhe normat e qëndrueshme të inflacionit në vendet partnere tregtare të Shqipërisë, kanë lehtësuar presionin e inflacionit të importuar.

Kursi i këmbimit. Pas një periudhe trevjeçare në të cilën leku ka ruajtur tendenca mbiçmuese ndaj valutave kryesore, kjo tendencë është zbehur gjatë vitit 2005. Kundrejt një viti më parë, leku është nënçmuar mesatarisht me 9.25 për qind ndaj usd dhe është mbiçmuar mesatarisht me 3.32 për qind ndaj euros. Tendencat mbiçmuese u vunë re më të forta gjatë gjysmës së parë të vitit ndërsa erdhën duke u ulur, dhe kursi i këmbimit të lekut qëndroi relativisht më stabil, gjatë gjashtëmujorit të dytë. Kjo ecuri ishte kryesisht pasojë e reduktimit të diferencës së normave të interesit lekë-valutë dhe e kërkesës më të lartë për valutë të huaj, si rezultat i rritjes së aktivitetit turistik të shqiptarëve jashtë Shqipërisë. Edhe ndërhyrjet valutore të Bankës së Shqipërisë, të përqëndruara në kahun e blerjes, kanë zbutur tendencat mbiçmuese të lekut.

2. STRUKTURA E SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR

2.1 NUMRI I BANKAVE

Viti 2005 pati si karakteristikë vazhdimin e zhvillimit dinamik të sistemit bankar në Shqipëri. Kjo dinamikë, në kuptim të licencimit të bankave dhe institucioneve të tjera financiare jobanka, reflektohet në aplikime të reja për licencë bankare, në shitje dhe ndryshime të strukturës së aksionerëve të bankave si dhe në një zgjerim të fuqishëm të rrjetit të bankave ekzistuese në zona të ndryshme të vendit.

Në fillim të vitit 2005 iu dha miratimi paraprak për licencë Bankës Union sh.a., një shoqëri me kapital vendas, për fillimin e aktivitetit bankar. Licenca përfundimtare kësaj banke, iu dha nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në dhjetor 2005. Me licencimin e Bankës Union, numri i bankave në Shqipëri rritet në 17, 3 nga të cilat janë banka me kapital vendas.

Po në vitin 2005 Banka e Parë e Investimeve – Bullgari, një subjekt me kapital të huaj, paraqiti kërkesën për transformimin e degës së Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë, në një filial të Bankës së Parë të Investimeve.

Një zhvillim të spikatur pati sistemi bankar shqiptar në vitin 2005, në drejtim të zgjerimit të rrjetit të tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2005 u hapën 48 degë dhe agjenci të reja me një shtrirje në të gjithë Shqipërinë, ku peshën më të madhe e zë rrethi i Tiranës. 23 degët dhe agjencitë e hapura në Tiranë janë të shtrira në të gjithë territorin e saj, duke mbuluar me shërbime bankare edhe zonat periferike dhe gjithashtu, zonat ku janë përqëndruar aktivitetet e biznesit të prodhimit, të tregtisë dhe të shërbimit.

Është rritur interesi i kapitalit të huaj, për të investuar në sistemin bankar në Shqipëri. Kështu, në qershor të vitit 2005 u miratua shitja e 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Dardania (aktualisht Banka Italiane e Zhvillimit), tek investitorë italianë. Gjithashtu, përparoi ndjeshëm procesi i shitjes së aksioneve të Shtetit Shqiptar në Bankën Italo-Shqiptare⁴. Njëkohësisht, u aplikua për ndryshimin e pronësisë të aksioneve të kapitalit të Bankës Kombëtare Tregtare⁵. Këto ndryshime u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në gjysmën e parë të vitit 2006, në kushtet kur Banka e Shqipërisë miraton ose refuzon transferimin e pronësisë mbi aksionet, kur ky transferim përbën 10 për qind e më tepër të kapitalit të bankës.

Gjatë vitit 2005 nuk ka patur aplikime të bankave për rritjen e nivelit të kapitalit, që lidhet me rritjen e veprimtarive të lejuara financiare.

Banka e Shqipërisë është njoftuar për ndryshimet në statutet e bankave që lidhen me rritjen e kapitalit themeltar, me ndryshimin e strukturës së aksionerëve dhe të pronësisë mbi aksionet në masën nën 10 për qind të kapitalit të bankës etj.. Këto ndryshime pasqyrohen në regjistrin e bankave, që mbahet në Bankën e Shqipërisë.

- *Krijimi i subjekteve jobanka, zyra të këmbimit valutor dhe shoqërive të kursim-kreditit*

Gjatë vitit 2005, Banka e Shqipërisë: a) licenoi 6 subjekte si zyra të këmbimit valutor dhe iu revokoi licencën 2 zyra të tjera; b) licenoi 3 shoqëri të reja të kursim-kreditit dhe iu revokoi licencën 7 shoqërive të tjera. Shoqëritë e kursim-kreditit, të cilave iu është revokuar licenca, janë bashkuar mbi bazën e 3 shoqërive ekzistuese të kursim-kreditit.

Në fund të vitit 2005, pas ndryshimeve të ndodhura, lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë sipas viteve paraqitet si më poshtë:

Tabelë 1. Lista e subjekteve të licencuara.

Nr.	Subjektet	2000	2001	2002	2003	2004	2005
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15	16	17
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7	7	7
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58	58	54	58
4	Shoqëri të kursim-kreditit			113	131	130	131
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit			2	2	2	2

- *Analiza financiare*

Analiza financiare e sistemit bankar për vitin 2005, është mbështetur jo vetëm në vështrimin në kohë të ecurisë së sistemit në tërësi, por edhe në krahasimin brenda të njëjtës periudhë, të bankave me njëra tjetrën, sipas disa kriterëve të caktuar. Për këtë qëllim, shërben ndarja e bankave në grupe, e cila bazohet mbi kriterin e madhësisë së aktiveve. Në këtë mënyrë, dallojmë tre grupe kryesore:

- Grupin e bankave me totalin e aktiveve më të vogël se 2 për qind - G1.
- Grupin e bankave me totalin e aktiveve më të madh se 2 për qind, por më të vogël se 7 për qind -G2.
- Grupin e bankave me totalin e aktiveve më të madh se 7 për qind - G3.

Gjatë vitit 2005, bankat u grupuan si më poshtë:

- Grupi 1(G1): Banka Emporiki (BE); Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH); Dega në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve (BPI); Banka Ndërkombëtare Tregtare (BTN); Banka e Kreditit e Shqipërisë (BKSh); Banka Popullore (BP); Banka Italiane e Zhvillimit (BIZH);
- Grupi 2 (G2): Dega në Tiranë e Bankës Alfa (BA); Banka Italo-Shqiptare (BISh); Banka Procredit (BPC); Dega në Tiranë e Bankës Kombëtare të Greqisë (BKG); Banka Credins (BC).
- Grupi 3 (G3): Banka Raiffeisen (BRF); Banka Tirana (BT); Banka Amerikane e Shqipërisë (BASH); Banka Kombëtare Tregtare (BKT).

2.2 STRUKTURA E PRONËSISË

Në ndryshim nga viti 2004, në të cilin privatizimi i ish-Bankës së Kursimeve rrjedhoi në ndryshime të ndjeshme të strukturës së kapitalit të sistemit bankar, viti 2005 nuk shënoi ndryshime të ndjeshme në kombinimin e kapitalit vendas me atë të huaj. Kështu, pesha e kapitalit të huaj llogaritet 87.2 për qind, nga 87.3 për qind një vit më parë. Brenda këtij grupi vlen të përmendet pesha në rritje e kapitalit të derdhur nga vendet e Bashkimit Evropian, me 1.3 pikë përqindjeje dhe zvogëlimi i kapitalit me origjinë nga vende të tjera, me 2.2 pikë përqindjeje.

Kapitali i huaj zotëron në grupin e bankave të mëdha (G3) duke zënë një peshë prej 100 për qind. Ndërkohë, edhe në grupet e tjera – grupin e bankave të mesme (G2) dhe të vogla (G1) – pesha e kapitalit të huaj tejkalon nivelin prej 50 për qind. Megjithëse, në grupet G3 dhe G2 struktura e pronësisë së kapitalit mbetet pothuaj e njëjtë me vitin e mëparshëm, grupi i bankave të vogla shënon rënien e peshës së kapitalit vendas në 23.2 për qind, nga 33.4 për qind dhe rritjen e peshës së kapitalit të huaj në 76.8 për qind, nga 66.6 për qind në fundvitin 2004. Këto ndryshime strukturore shpjegohen me lëvizjen e bankave nga njëri grup në tjetrin, si rezultat i zhvillimeve në veprimtarinë e tyre.


Bazuar në peshën e aktiveve të bankave me kapital të huaj, evidentojmë rënien e peshës së aktiveve të zotëruara nga bankat me kapital të huaj në 90.5 për qind (nga 94.1 për qind në fundin e vitit 2004) dhe rritjen e peshës aktiveve të zotëruara nga bankat me kapital vendas, në 6.4 për qind (nga 2.9 për qind në fundin e vitit 2004).

Në qoftë se marrim në konsideratë kontrollin direkt⁶ dhe indirekt të totalit të aktiveve, aksionerët e huaj zotërojnë një kontroll prej 93.5 për qind të totalit të aktiveve të sistemit, nga 97.1 për qind në vitin e mëparshëm.


2.3 NUMRI I PUNONJËSVE DHE I DEGËVE TË BANKAVE

Gjatë vitit 2005, sistemi bankar vazhdoi zgjerimin e shpejtë të rrjetit të tij brenda territorit të Republikës


Grafik 1. Struktura e pronësisë së kapitalit të sistemit bankar, në vite.




Grafik 2. Struktura e pronësisë së kapitalit sipas grupbankave.



Grafik 3. Struktura e totalit të aktiveve të sistemit bankar sipas pronësisë.



Grafik 4. Numri i degëve/agjencive (në përqindje) sipas grupbankave⁷.




së Shqipërisë. U hapën më shumë se 50 degë dhe agjenci në të gjithë territorin e vendit, por pjesa më e madhe e tyre ishte në qytetin e Tiranës. Një numër i konsiderueshëm degësh dhe agjencish janë hapur në rrethe të vogla të vendit si dhe në qyteza të vogla, çka është një tregues se një pjesë gjithnjë e më e madhe e popullsisë po mbulohet me shërbime bankare.

Degë dhe agjenci të reja kanë hapur pothuajse të gjitha bankat, por edhe këtë vit ashtu si dhe në vitin 2004, bie në sy rritja me 29 degë dhe agjenci e bankave të vogla (Grupi G1).

Numri i punonjësve edhe për vitin 2005, pësoi një rritje të konsiderueshme prej 24 për qind, krahasuar me një rritje prej 26 për qind në vitin 2004. Kjo rritje e ndjeshme e numrit të punonjësve, lidhet kryesisht me zgjerimin e rrjetit të sistemit bankar por edhe me rritjen e veprimtarisë së bankave dhe me konsolidimin e strukturës organizative të tyre. Në fund të vitit 2005, në sistemin bankar shqiptar ishin të punësuar 3,479 persona, nga 2,816 persona një vit më parë.

Grafik 5. Numri i punonjësve (në përqindje) sipas grupbankave.



Në dallim me një vit më parë, në vitin 2005 numri i punonjësve për një njësi bankare ka pësuar rënie. Kështu, në vitin 2005 bankat kanë 13.9 punonjës për njësi bankare, nga 15 që kishin në vitin 2004. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të degëve dhe agjencive me një ritëm më të lartë sesa rritja e numrit të punonjësve. Një pjesë e konsiderueshme e degëve dhe agjencive të hapura, kanë qenë në zona me pak popullatë dhe si rrjedhojë, dhe numri i punonjësve në këto degë e agjenci të reja ka qenë i ulët.

Një rritje të konsiderueshme ka shënuar numri i punonjësve të kredisë, në përgjigje edhe të rritjes së konsiderueshme që ka patur kredidhënia gjatë vitit 2005 dhe objektivave për një rritje të mëtijshme në periudhat në vazhdim. Në shumë banka është vënë re një ristrukturim i njësive të kredive, duke patur si qëllim një ndarje më të qartë të detyrave dhe përgjegjësisë.

Rritja e numrit të bankave, të degëve dhe agjencive të tyre, si dhe e numrit të punonjësve, ka bërë që të përmirësohet ndjeshëm mbulimi i popullatës. Kështu, kemi patur një rënie të ndjeshme të numrit të banorëve për bankë, njësi bankare si dhe të numrit të banorëve për një punonjës banke.

	2003	2004	2005
Numri i punonjësve	2,236	2,816	3,479
Numri i degëve, agjencive	161	188	250
Numri i punonjësve për:			
Bankë	149	176	217
Njësi bankare	13.9	15	13.9
Numri i banorëve për ⁸ :			
Bankë	206,851	194,971	184,410
Njësi banke	20,815	16,593	12,539
Punonjës banke	1,388	1,108	901

Tabelë 2. Mbulimi me shërbime bankare.

2.4 TEKNOLOGJIA E RE

Gjatë vitit të fundit është vënë re një përmirësim në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, në sistemin bankar shqiptar. Kjo është treguar në përmirësimet e bëra në programet e përdorura dhe në blerjen e programeve të reja nga disa banka. Këto programe, mbështesin më mirë kërkesat e manualit të kontabilitetit bankar si edhe nevojat e institucionit për zgjerim të veprimtarisë dhe prezantime të shërbimeve të reja, si për shembull *e-banking*.

Kjo gjë është mbështetur edhe nga ana e Bankës së Shqipërisë me hartimin e rregullores "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë" dhe miratimin me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 3 maj 2006. Kjo rregullore do të ndihmojë jo vetëm për një mbikëqyrje sa më korrekte dhe të plotë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të përdorur prej bankave por njëkohësisht, do të ndihmojë bankat në punën e përditshme, si dhe në masat e sigurisë që ato duhet të aplikojnë për sigurimin dhe mirëpërdorimin e informacionit, ruajtjen e këtij informacioni dhe sigurimin e vazhdimësisë së punës në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme.

Megjithatë, mbetet akoma mjaft punë për t'u bërë në këtë fushë nga disa banka, sidomos në lidhje me sigurinë dhe me programet e përdorura prej tyre. Një vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet plotësisht të këtyre programeve me të gjitha modulet e nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.

Është gjithashtu e nevojshme, që kontrolli i brendshëm i bankës (ose edhe ai i jashtëm i ofruar nga kompanitë konsulente) të shtrihet, duke e përfshirë plotësisht edhe teknologjinë e informacionit. Ky kontroll, i cili aktualisht kufizohet vetëm në lidhje me profilet e përdoruesve të sistemit ose të drejtat e aksesit që ata kanë në sistem, duke e krahasuar atë me pozicionin e punës që kanë, duhet të përfshijë edhe çështje që lidhen me funksionalitetin e këtyre sistemeve, saktësinë e gjenerimit të informacionit, ndryshimet e kryera në sistem, sigurinë e informacionit gjatë punës dhe në transmetim (për degët e lidhura on-line) etj..

ATM,

Makinat elektronike të kartëmonedhave (ATM-të), pësuan një zhvillim të mëtejshëm gjatë vitit 2005. Pjesa më e madhe e bankave ka krijuar një rrjet

ATM-sh në Tiranë dhe në qytete të tjera kryesore të vendit. Numri i terminalëve elektronike është rritur, ndërsa numri i përdoruesve të tyre u rrit gjithashtu, nga rreth 34,090 në rreth 225,900. ATM-të përdoren nëpërmjet kartave të debitit, por edhe kartat e kreditit po gjejnë përdorim të gjerë. Si "Visa" ashtu edhe "MasterCard" janë aktive në Shqipëri dhe pjesa më e madhe e bankave janë anëtare në një prej tyre, duke ofruar kartat përkatëse. Ndonëse, përdorimi i kartave është ende i kufizuar, rritja e numrit të njësisë të shërbimit që pranojnë pagesa në mënyrë elektronike (POS-Point of Sale) nga 155 në 780, si edhe ndryshimi gradual i mendësisë që favorizon mbajtjen e parasë në formën e cash-it, do të çojë në rritje të përdorimit të kartave si mjet pagese.

E-banking

Shërbimi i transaksioneve në rrugë elektronike (e-banking) si produkt bankar u shfaq pas vitit 2000, por mund të thuhet se nuk ka shënuar nivelin e kërkuar të njohjes dhe të përdorimit nga publiku. Deri në fund të vitit 2005, dy banka e ofronin këtë shërbim për klientë të veçantë (kryesisht bizneset) për kryerjen e transfertave, pagesave të ndryshme etj.. Disa banka të tjera planifikojnë ofrimin e këtij shërbimi gjatë vitit 2006.

2.5 PËRQËNDRIMI

Sistemi bankar në Shqipëri gjatë vitit 2005, ka shfaqur tendenca pozitive në drejtim të shpërndarjes më të mirë të burimeve financiare dhe për rrjedhojë, edhe të aktiveve ndërmjet bankave.

Tabelë 3. Indeksi H (Herfindahl) i përqëndrimit të aktiveve dhe depozitave.

	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Indeksi H (aktivet)	0.44	0.37	0.32	0.30	0.27	0.21
Indeksi H (depozitat)	0.50	0.43	0.37	0.35	0.31	0.24
Indeksi H (kredia)	0.27	0.20	0.17	0.15	0.11	0.10

Treguesi i Herfindahlit për zërin kryesor të burimeve financiare që janë depozitat, si edhe për totalin e aktiveve evidenton një rënie të qëndrueshme. Pakësimet e vlerave të indeksit në krahasim me fundvitin 2004, përkatësisht me 0.06 pikë për totalin e aktiveve dhe 0.07 pikë për totalin e depozitave, shënojnë ritmet më të larta rënëse në vite, me përjashtim të zhvillimeve të indeksit për vitet 2000 - 2001. Indeksi i përqëndrimit të depozitave ka rënë nga 0.50 në vitin 2000, në 0.24 në vitin 2005 duke iu afruar gjithnjë e më tepër niveleve optimale.


Përmirësimi i kushteve të konkurrencës, shpjegohet nga të paktën dy faktorë: së pari, rritja e numrit të bankave në treg nga 16 në 17; së dyti, rritja e peshës së disa bankave në sistem me ritme rritjeje më të larta se ajo e bankave më të mëdha.

Ndërkaq, vlera e indeksit për totalin e tepërisë së kredisë, llogaritet në nivele mjaft më të ulëta se vlera e indeksit për totalin e aktiveve apo të depozitave, gjë që tregon për përqëndrim të kufizuar të kredihënies në sistem. Përsa

i përket kredihënies, nuk kemi ndonjë bankë që të ketë një peshë tregu dukshëm më të madhe se bankat e tjera, por kemi një grup bankash me një peshë tregu pranë njëra-tjetrës. Kjo tregon për një shpërndarje më të balancuar të portofolit të huave në vlerë absolute, i cili reflektohet në një vlerë relativisht të ulët të treguesit Herfindahl për kreditë.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive, bankat më të mëdha të sistemit (të agreguara në grupin 3) BRF, BASH, BKT, BT, vazhdojnë të mbizotërojnë sistemin bankar. Pesha e totalit të aktivitetit për këto banka ndaj totalit të aktiveve të sistemit, ndonëse shfaq një rënie, është në nivelet prej 72.5 për qind, çka tregon se këto banka vazhdojnë të kenë qëndrueshmëri të veprimtarisë së tyre.

Në lidhje me ndikimin e grupbankave në rritjen e aktiveve të sistemit gjatë vitit 2005, evidentohet një rritje e grupit G3 me 33.3 miliardë lekë, G2 me 20.6 miliardë lekë dhe G1 me 16.2 miliardë lekë. Kontributi i bankave të G3, ndonëse është më i lartë në terma absolutë se dy grupet e tjera të bankave, është më i ulët në terma relativë (rritja në përqindje krahasuar me një vit më parë), gjë që do të thotë se ritmi i rritjes së aktiveve të bankave të këtij grupi, ka qenë më i ulët se ai i bankave në grupet e tjera. Theksojmë se tendenca në rënie e kontributit të bankave të mëdha në rritjen e sistemit, flet për reduktim të përqëndrimit të aktiveve të sistemit bankar.



2.6 AKTIVET DHE PASIVET

2.6.1 Totali i aktiveve dhe struktura e tyre


Gjatë vitit 2005 aktivet e sistemit bankar shënuan rritje me 70.1 miliardë lekë ose prej 16.4 për qind. Viti 2005 evidenton shpërndarje më të diversifikuar të portofolit të sistemit bankar. Më konkretisht, “veprimet me thesarin dhe ndërbankare” shënojnë rënie si në vlerë absolute ashtu dhe në peshë specifike ndaj totalit të aktiveve. Krahasuar me fundin e vitit 2004, efektin kryesor e ka dhënë pakësimi i investimeve të sistemit në bono thesari të Qeverisë Shqiptare, me rreth 10 pikë përqindjeje ndaj totalit të portofolit.

Gjatë vitit 2005, sistemi bankar në përgjithësi ka theksuar orientimin drejt aktivitetit kreditues. Portofoli i kredisë përbën 26 për qind të aktiveve, krahasuar me 16 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Ndërkohë, bankat e sistemit po shtrihen edhe në investime të reja fitimprurëse, siç janë letrat me vlerë të qeverive të huaja, obligacione të emetuara nga Qeveria Shqiptare, korporata, banka të huaja apo institucione të tjera financiare. Ky grup llogaritet rreth 12 për qind e totalit të aktiveve të sistemit në fundvitin 2005, ndonëse obligacionet e Qeverisë Shqiptare përbëjnë peshën kryesore të këtij grupi me rreth 64 për qind.


Grafik 7. Struktura e aktiveve.



Grafik 8. Struktura e pasiveve.



Grafik 9. Teprica e kredisë bruto, ecuria tremujore kumulative (në miliardë lekë).



Ndonëse struktura e aktiveve të sistemit bankar dallon ndryshime të ndjeshme nga njëri vit në tjetrin, struktura e fondeve/burimeve të sistemit mbetet pothuaj e njëjtë, pavarësisht ndryshimit të shpërndarjes së tyre midis bankave. Elementet kryesore që kanë ndikuar në rritjen e burimeve janë depozitat e sistemit bankar, të cilat kanë pësuar një rritje prej rreth 16.4 për qind në krahasim me një vit më parë, pasuar nga rritja e kapitalit aksioner me rreth 27.2 për qind. Rritja e depozitave të sistemit tregon për një besim në rritje të publikut ndaj sistemit bankar dhe është një tregues i zvogëlimit të informalitetit dhe rritjes së eficiencës së kursimeve të popullatës, në tërësi.

3. ADMINISTRIMI I RREZIQEVE NË VEPRIMTARINË BANKARE

3.1 RREZIKU I KREDITIT

3.1.1 Aktiviteti kreditues

Gjatë vitit 2005, teprica e kredisë së sistemit bankar shënoi rritje me 57.6 miliardë lekë⁹ ose 82 për qind, nga 19.3 miliardë lekë ose 38 për qind për vitin e mëparshëm. Ritmi i lartë rritës flet për shtrirjen e konsiderueshme të sistemit bankar në kredidhënie, ngjarje kjo e parashikuar në momentin e privatizimit të ish-Bankës së Kursimeve. Pavarësisht se BRF evidenton në fund të vitit 2005, një portofol huaje relativisht të vogël ndaj totalit të aktiveve, është kjo bankë e cila ka dhe kontributin më të madh në rritjen e portofolit të huave gjatë vitit 2005. Edhe bankat e tjera, ndonëse me një rritje disi më të ulët, kanë shfaqur ecuri të mirë në lidhje me aktivitetin kreditues.

Ndërkohë, ritmi i konsiderueshëm rritës i tepricës së kredisë, në krahasim me fundvitin 2004 është reflektuar edhe në ndryshimin e strukturës së kredisë sipas afatit. Nga analiza rezulton se kredia afatshkurtër ka ruajtur të njëjtin ritëm rritjeje, ndërsa dallohet një zhvendosje e kredisë afatmesme në kredi afatgjatë, sidomos kur krahasimi bëhet me fundin e vitit 2004. Besojmë se këto zhvillime strukturore, sipas afatit për portofolin e kredive, janë shprehje të kërkesave të individëve për investime në pasuri të patundshme, por edhe të orientimit

të bizneseve drejt investimeve në mjete të qëndrueshme, të nevojshme në përmirësimin e teknologjisë apo zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit, më tepër sesa rritje të kërkesave për kapital qarkullues. Sidoqoftë, kjo tendencë konsiderohet pozitive, jo vetëm në drejtim të kontributit për rritje të mëtejshme dhe të qëndrueshme të ekonomisë, një element i rëndësishëm për të siguruar stabilitet financiar, por edhe në përmirësimin e perceptimit të sistemit bankar për ecurinë e ekonomisë dhe të rreziqeve specifike, në periudha më afatgjata kohore.

Tabelë 4. Struktura e tepricës së kredisë sipas afatit.


Struktura e kredisë (në % ndaj tepricës së kredisë)	Qershor'04	Shtator'04	Dhjetor'04	Mars'05	Qershor'05	Shtator'05	Dhjetor'05
Kredi afatshkurtër	28.8	26.9	26.7	26	27.5	25.8	26.2
Kredi afatmesme	35.7	35.9	35.3	33.9	33.1	32.3	30.6
Kredi afatgjatë	29.3	31.2	30.9	32.2	32.8	35.2	36.2

Në lidhje me kontributin e grupbankave në rritjen e tepricës së kredisë, për vitin 2005 evidentohen grupet G3, G2 dhe G1 respektivisht me 28.4 miliardë lekë, 22.8 miliardë lekë dhe 6.4 miliardë lekë. Tremujori i katërt vazhdon të shënojë rritjen e peshës së bankave të mëdha në totalin e tepricës së sistemit. Gjithsesi, peshë e arritur është 3 pikë përqindjeje në nivelin e të njëjtës periudhë për vitin 2004.


3.1.2 Cilësia e kredive

Gjatë vitit 2005 identifikohet një ritëm më i lartë rritës i tepricës së kredisë kundrejt tepricës së kredive me probleme. Për rrjedhojë, treguesi i rëndësishëm i cilësisë së portofolit të kredive "kredi me probleme/tepricës së kredisë (bruto)" ra në nivelin 2.3 për qind, nga 4.2 për qind në fundvitin 2004. Këto zhvillime tregojnë për një përmirësim të cilësisë së portofolit të kredive, që ka ardhur nga elemente sasiore (rritja e kredisë) dhe jo cilësore, si reduktimi i portofolit të kredive me probleme. Gjithashtu, përvoja ndërkombëtare tregon që një rritje e shpejtë e portofolit të huave, sikurse ka ndodhur gjatë vitit 2005, përgjithësisht shoqërohet me një përkeqësim të portofolit të huave në periudha të mëvonshme. Për rastin tonë, në një mjedis që mbart rreziqe operacionale, që lidhen me infrastrukturën e veprimit të bizneseve në përgjithësi, mundësia për të marrë vendime të veçanta që mund të rezultojnë të gabuara është më e madhe në kushtet e rritjes së agresivitetit të bankave.

Grafik 10. Kredia e re e akorduar nga sistemi bankar (në miliardë lekë).



Grafik 11. Peshat e grupbankave në totalin e tepricës së kredisë së sistemit bankar (në %).



Struktura e kredisë sipas cilësisë shfaq përmirësime, në krahasim me fundin e vitit 2004. Evidentohet një rritje e lehtë e peshës së tepricës së klasifikuar “standarde” dhe një rënie gjithashtu e lehtë, e kategorive “të dyshimta” dhe “të humbura”.

Tabelë 5. Klasifikimi i kredisë në përqindje ndaj tepricës së kredisë.

Klasifikimi i kredisë	2003				2004				2005
	T IV	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV
Kredi standarde	92.3	91.8	91.5	91.6	92.8	92.5	94.9	94.2	94.1
Kredi në ndjekje	3.1	3.6	4.5	3.8	3.2	4.1	2.8	3.4	3.6
Kredi nënstandarde	1.9	0.6	0.5	0.8	1.0	0.9	0.6	0.9	0.8
Kredi të dyshimta	0.5	1.4	0.9	1.4	1.0	0.9	0.5	0.4	0.5
Kredi të humbura	2.1	2.6	2.6	2.4	2.1	1.6	1.2	1.1	1.0

Treguesi “kredi me probleme / tepricës së kredisë (neto), i cili mat madhësinë neto të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë shënon nivele të ulëta, madje me një tendencë në rënie gjatë periudhave¹⁰.

Së fundi, aftësia e sistemit bankar për të mbuluar me kapital humbjet nga kreditë¹¹ evidentohet e përmirësuar, si rrjedhojë e ritmit më të lartë rritës të kapitalit rregullator (plus 34.7 për qind), kundrejt rritjes së tepricës neto të kredisë me probleme¹² (plus 23 për qind).

Megjithë dominimin e kredisë në valutë, kredia në lekë prezanton rritje të peshës së saj ndaj tepricës së kredisë (në 24.4 për qind nga 19.5 për qind në fundvitin 2004). Nga analiza, rezulton se kredia në valutë, ku fluksi i të ardhurave të kredimarrësit është në lekë, llogaritet rreth 42 për qind e tepricës së kredisë në valutë ose 34 për qind e tepricës së kredisë gjithsej. Ndonëse, në pamje të parë, sistemi shfaqet i ekspozuar ndaj rrezikut indirekt të kreditit, që do të thotë se luhatjet e ndjeshme të kursit të këmbimit mund të shkaktojnë humbje në portofolin e kredisë, skenaret hipotetike që marrin në konsideratë nënçmimin e lekut me 20 pikë përqindjeje, rezultojnë në rënie të normës së mjaftueshmërisë së sistemit bankar, me vetëm 1.6 pikë përqindjeje.

Tabelë 6. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave.

Struktura e kredisë (në % ndaj tepricës së kredisë)	Qersh.'04	Shtator '04	Dhjetor'04	Mars'05	Qersh.'05	Shtator'05	Dhjetor'05
Teprica e kredisë në lekë	16.8	16.7	19.5	20.1	22.3	22.4	24.4
Teprica e kredisë në valutë	83.2	83.3	80.5	79.9	77.7	77.6	75.6

3.2 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Likuiditeti i sistemit bankar ka qenë i kënaqshëm edhe për vitin 2005. Bankat kanë qenë më aktive në tregun ndërbankar për të plotësuar nevojat e tyre operacionale, ndërsa Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në treg, për thithjen e likuiditeteve të tepërta apo injektimin e likuiditetit. Gjithashtu, treguesit kryesorë të sistemit për likuiditetin prezantojnë nivele, të cilat nuk

kanë cënuar situatën e likuiditetit. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, për të mbajtur norma reale interesi në lekë dhe një normë inflacioni nën kontroll, si edhe rritja e normave të interesit për monedhat e huaja kryesore, veçanërisht usd, kanë kontribuar jo vetëm në qëndrueshmërinë e depozitave, por edhe në rritjen e tyre në sistemin bankar.

Më konkretisht, në analizën e likuiditetit do të vazhdojmë të konsiderojmë si tregues të tij: raportet e likuiditetit¹³ dhe gap-in e maturimit.

3.2.1 Raportet e likuiditetit

Raporti “aktive likuide mbi totalin e aktiveve” për bankat e sistemit, shënoi nivelin mbi 20 për qind, në fundin e vitit 2005.

Raporti “aktive afatshkurtra mbi pasive afatshkurtra” për sistemin bankar ruajti prirjen në rënie edhe në tremujorin e fundit të vitit, duke shënuar në fund të tij nivelin 80 për qind. Ky raport është rreth 17 pikë përqindje më i ulët, krahasuar me fundvitin 2004 dhe niveli më i ulët i arritur nga sistemi gjatë këtyre tre viteve të fundit. Treguesi, ndonëse njeh rënie, vazhdon të ruajë nivel të kënaqshëm për sistemin, gjë e cila tregon për një administrim të mirë të likuiditetit. Në sistem dallohen disa banka, të cilat njohin vlera të ulëta të treguesit, por niveli i kënaqshëm i aktiveve likuide në totalin e aktiveve të tyre nuk i ekspozon këto të fundit ndaj rrezikut të likuiditetit¹⁴.

Treguesi (në milionë lekë)	Dhjetor 2003	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005
1. Aktive afatshkurtra	151,356	154,788	166,364
2. Pasive afatshkurtra	141,276	160,067	207,852
(1)/(2) (në %)	107	97	80

Tabelë 7. Ecuria e raportit të aktiveve afatshkurtra ndaj pasiveve afatshkurtra për sistemin bankar në vite.

3.2.2 Gap-i i maturimit deri në 1 muaj

Gap-i i maturimit deri në 1 muaj, që prezanton diferencën e aktiveve me pasivet me maturim të mbetur deri në një muaj, i agreguar për sistemin është në nivelin 15 për qind të totalit të aktiveve.

3.3 RREZIQET E TREGUT

Sistemi bankar në Shqipëri, referuar edhe tremujorit më të fundit të vitit 2005, prezanton një rrezik të kufizuar në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit dhe rrezikun e normës së interesit. Vlen të theksohet se monedhat kryesore të huaja me të cilat operon sistemi bankar, janë euro dhe dollari amerikan (usd). Euro ka fituar një terren më të madh përdorimi ndaj usd, si rrjedhojë e forcimit gradual të saj në tregjet ndërkombëtare dhe e forcimit të marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë me vendet e Bashkimit Evropian. Këto njësi monetare konsiderohen si monedha të forta, me një stabilitet të spikatur

sidomos në periudha afatmesme, ndërkohë që edhe kursi i këmbimit të lekut kundrejt tyre ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm, duke ndjekur ecurinë e zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare për periudha më të gjata kohore.

Në fund të vitit 2005, nga të dhënat e raportuara, nën këndvështrimin rregullator të rrezikut të kursit të këmbimit, të gjitha bankat e sistemit¹⁵ evidentonin pozicione të hapura brenda kufirit rregullator prej 20 për qind, për çdo monedhë, ndaj kapitalit rregullator. Në fund të vitit 2005, me përjashtim të tre bankave të sistemit, të gjitha bankat e tjera llogarisnin kërkesë për kapital rregullator në masën 1 për qind të kapitalit rregullator faktik, për të mbuluar rreziqet nga ndryshimi i kursit të këmbimit. Ky nivel konsiderohet i parëndësishëm dhe plotësisht i mbulueshëm nga kapitali rregullator i bankave, në fund të vitit 2005.

Edhe rreziku i normës së interesit vlerësohet i kufizuar, kryesisht për këto arsye:

- sistemi bankar në Shqipëri dominohet nga një strukturë aktiv-pasivesh me maturim afatshkurtër;
- përbërja e aktiveve dhe pasiveve konsiston në monedhën lokale, lek, në euro dhe usd. Këto monedha, sidomos euro dhe usd, karakterizohen nga një çmim i brendshëm apo norma interesi, që nuk shfaqin zhvillime të shpejta, të cilat mund të shkaktojnë një stres financiar të paparashikuar;
- portofoli i letrave me vlerë klasifikohet pothuaj për qëllime investimi, gjë që nuk i ekspozon bankat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj lëvizjeve të herëpashershme të çmimeve në tregjet e letrave me vlerë;
- përgjithësisht plotësohet minimumi i synuar i raportit të mbulimit prej 100 për qind, i cili përfaqëson raportin ndërmjet kapitalit rregullator faktik ndaj kërkesës për kapital rregullator, që vjen si rezultat i kërkesës për mbulimin e rrezikut të normës së interesit.

Në fund të vitit 2005, struktura e aktiveve dhe pasiveve të bankave dhe sistemit bankar në tërësi, dominohet në pjesën më të madhe, nga aktiv-pasive që nuk kalojnë harkun kohor të një viti, apo me maturim të mbetur mbi një vit dhe të rishikueshëm brenda një viti. Në këtë këndvështrim, investimet në letrat me vlerë, ndonëse në një pjesë të mirë të bankave zënë një peshë të konsiderueshme, karakterizohen nga letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare, bono thesari dhe në një masë shumë të vogël obligacione të Qeverisë Shqiptare me maturim jo më të madh sesa tre vjet. Këto të fundit, janë pjesë e portofolit të letrave me vlerë me të ardhura fikse dhe përbëjnë vetëm 12 për qind të totalit të aktivitetit, nga të cilat vetëm rreth 63 për qind e tyre kishin një maturim më të madh se periudha kohore prej një viti. Element tjetër i pjesës së aktiveve që ka një maturim mbi një vit, ishte edhe rreth 66 për qind e portofolit të kredive. Ky element e humbet rëndësinë nga pikëpamja e rrezikut të normës së interesit, në kushtet kur portofoli i huave zinte vetëm 26 për qind të totalit të aktiveve, ndërsa huatë janë subjekt i rishikimit të normave të interesit, të paktën brenda harkut kohor të një viti. Pjesa tjetër e investimeve iu takon kryesisht depozitave në monedhë të huaj në tregjet e parasë.

Në krahun e pasiveve, burimet gjenerohen pothuaj në pjesën më të madhe nga depozitat, që karakterizohen nga një trend i qëndrueshëm në rritje dhe një maturitet deri në një vit, ndonëse tek disa banka vihen re edhe pranime përtej maturimit prej një viti deri në tre vjet. Sidoqoftë, pjesa e tyre në totalin e depozitave të sistemit zë një nivel pothuaj të pakonsiderueshëm prej rreth 2.4 për qind. Edhe burimet e veta të bankave janë të qëndrueshme, madje në rritje, duke kontribuar në këtë mënyrë, për një përshtatje sa më të mirë me tentativat e bankave për t'u shtrirë edhe në investime me afate kohore mbi një vit.

4. MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Kapitali aksioner i sistemit njih një rritje rreth 7 miliardë lekë ose 27 për qind, në krahasim me fundvitin 2004. Viti 2005 dallon kontributin më të lartë të grupit të bankave të mesme (G2) në kapitalin aksioner të sistemit, me rreth 5.9 miliardë lekë, ndërsa grupi i bankave të mëdha (G3) shënon rritje rreth 728 milionë lekë dhe grupi i bankave të vogla (G1) rreth 408 milionë lekë.

Në fund të vitit 2005, struktura e kapitalit aksioner të sistemit dhe ecuria e elementeve përbërëse të tij, që dallojnë kontributin e tyre në nivelet e kapitalit jepet si më poshtë:

Tabelë 8. Struktura e kapitalit aksioner.

Treguesit	Dhjetor 2003		Dhjetor 2004		Dhjetor 2005	
	në milionë lekë	në %	në milionë lekë	në %	në milionë lekë	në %
Kapitali i vet aksioner	21 984.9	100.0	25 949.5	100.0	33 013.8	100.0
Kapitali i paguar ¹⁶	18 512.3	69.3	23 593.5	71.5	29 420.3	77.4
Primet e aksioneve			1.8	0.0	1.8	0.0
Rezervat	4 517.5	20.5	2 436.8	9.4	1 432.9	4.3
Diferenca rivlerësimi	-3 285.8		-5 033.8		-3 852.3	
Fitimi/humbja e pashpërndarë	-180.9		-155.0		-184.3	
Fitimi/humbja e vitit në vazhdim	2 422.0	11.0	5 106.1	19.7	6 195.5	18.8

Elementi kryesor i kapitalit aksioner, kapitali i paguar, ruan peshën kryesore (rreth 77 për qind) në kapitalin aksioner të sistemit, madje shënon rritje rreth 5 pikë përqindje ose 5.8 miliardë lekë më shumë se në fundvitin 2004. Ishin nëntë banka në sistem që rritën nivelet e kapitalit të paguar gjatë vitit, duke dhënë ndikim pozitiv në treguesin e sistemit. Rezervat e kapitalit shënuan rënie rreth 1 miliard lekë, fitimi i periudhës ruajti ndikimin pozitiv në kapital (me rreth 1 miliard lekë), ndërkohë që diferencat debitore të rivlerësimi ndonëse shënuan rënie (rreth 1.2 miliardë lekë), vazhdojnë të ruajnë ndikimin negativ në kapitalin e sistemit.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e sistemit ruan të paprekur, edhe gjatë vitit 2005, nivelin minimal të kërkuar mbi 12 për qind për të gjitha bankat. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit¹⁷ për sistemin bankar, në fund të vitit, shënon nivelin 19 për qind ose rreth 3 pikë përqindjeje më të ulët se në fundvitin 2004. Raporti në fjalë ka

reflektuar zgjerimin e veprimtarisë së sistemit bankar drejt aktiveve me nivel më të lartë të ponderimit, për efekt të llogaritjes së normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Ndërkohë, niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit varion në banka të ndryshme, ku bankat më aktive evidentojnë një nivel të mjaftueshmërisë së kapitalit shumë afër nivelit minimal të kërkuar.

Ndikimin kryesor në rënien e niveleve të treguesit e jep rritja me ritme shumë më të larta e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut (rreth 54 miliardë lekë ose 57 për qind), krahasuar me nivelet e kapitalit rregullator (7 miliardë lekë ose rreth 35 për qind). Viti 2005 shënoi rritje të konsiderueshme të investimeve të bankave kryesisht në kredidhënie, si aktiviteti më me rrezik (dhe më fitimprurës) për këto të fundit. Kjo, gjen pasqyrim në rritjen e konsiderueshme të aktiveve të klasifikuara me rrezik të lartë, të cilat njohin rritje rreth 52 miliardë lekë ose 73 për qind, krahasuar me fundvitin 2004. Nivelet në rënie të mjaftueshmërisë së kapitalit flasin për efektivitet më të lartë të veprimtarisë së bankave, për aq kohë sa vazhdojnë të ruhen nivelet minimale të kërkuara.

Tabele 9. Ecuria e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut për sistemin bankar në vite.

Treguesi (në milionë lekë)	Dhjetor 2003	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005
Aktive pa rrezik	254 548.6	271 216.7	292 452.4
Aktive me rrezik të ulët	67 655.5	71 384.0	71 480.4
Aktive me rrezik të mesëm	8 031.1	8 892.7	11 759.0
Aktive me rrezik të lartë	40 339.1	70 805.8	122 319.5
Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të klasifikuar sipas rrezikut ¹⁸	62 237.6	94 800.7	148 757.1

Një vështrim në mjaftueshmërinë e kapitalit sipas grupbankave të sistemit, dallon të njëjtin pozicionim të treguesit si në fundvitin 2004. G1 ruan nivelin më të lartë të treguesit të mjaftueshmërisë me 35 për qind, G2 shënon nivelin 19 për qind dhe G3 një nivelin më të ulët me 14 për qind. Tendenca në rënie e treguesit është më e dukshme në grupin e bankave të vogla (rreth 12 pikë përqindje), ndërkohë që në G2 dallojnë me kontribut më të lartë tre banka, ndërsa në G3 vazhdon të japë ndikim të ndjeshëm BRF, krahas bankave të tjera të grupit, të cilat ruajnë ritme të konsiderueshme rritjeje në kredidhënie.

Theksojmë se diferenca e normave të mjaftueshmërisë së kapitalit ndërmjet grupbankave, nuk është rrjedhojë vetëm e përfshirjes së tyre në aktive me më tepër apo më pak rrezik. Analiza dallon si një element thelbësor nivelin e levës financiare, e cila gjithashtu varion. Në mënyrë më specifike, efekti i pasjes së një leve financiare më të lartë në nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit identifikohet në bankat e G3. Këto banka edhe pse kanë një peshë të portofolit të huave ndaj totalit të aktiveve më të ulët se bankat e G2, kanë një levë financiare të lartë, gjë që bën që ato të kenë një nivel mjaftueshmërie kapitali më të ulët se ai i bankave të G2. Në të kundërt, bankat G1 dhe G2 kanë një levë financiare të përafërt dhe ndryshimi i mjaftueshmërisë së kapitalit, vjen më tepër nga niveli i përfshirjes së bankave të grupeve përkatëse në aktive me më tepër apo më pak rrezik.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në %	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Dhjetor 2005	18.6	35.0	19.4	14.4
Dhjetor 2004	21.6	47.3	17.8	17.3
Dhjetor 2003	28.5	72.0	21.4	23.0

Tabelë 10. Ecuria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave në vite.

Për vitin 2005, rezultati neto pozitiv i sistemit bankar ishte 1,357.18 milionë lekë, rreth 29 për qind më i lartë se në fundin e vitit 2004. Rritja e rezultatit neto me rreth 1,492 milionë lekë, përcaktohet nga orientimi i sistemit në aktive më fitimprurëse, tipikisht hua, të cilat janë rritur me rreth 82 për qind mbi baza vjetore. Këto zhvillime, pasqyrohen edhe në peshën që zë portofoli i huave ndaj totalit të aktiveve, nga 16.4 për qind në fund të vitit 2004, në rreth 26 për qind në fund të vitit 2005.

Treguesit	Dhjetor '05	Shtator '05	Dhjetor '04
Rezultati neto nga interesat	4,916.08	4,316.46	3,017.82
Rezultati neto nga veprimtaritë e tjera	1,171.06	1,008.13	1,103.44
Shpenzimet e veprimtarisë	3,093.09	2,764.37	2,363.91
Shpenzime për provigjone	555.15	218.09	229.22
Rezultati neto (pas tatimit)	1,357.18	1,924.17	914.95

Tabelë 11. Ecuria e elementeve kryesore të rezultatit neto (jo kumulative) në milionë lekë.

Analiza e detajuar e rezultatit neto dhe e strukturës së tij, tregon se kontribuesi kryesor i rezultatit neto për vitin 2005 është rezultati neto nga interesat. Rritja e të ardhurave nga interesi është rrjedhojë e kthimit nga huatë e dhëna në mënyrë intensive gjatë dy vjetëve të fundit, si edhe rritja e normës së interesit për kreditë në valutë, në kushtet e rritjes së tyre në tregjet ndërkombëtare. Këtu, duhet mbajtur në konsideratë edhe fakti, që rritja e normave të interesit në krahun e aktiveve ka qenë më e shpejtë se në atë të pasiveve.

Një tjetër element i rëndësishëm janë shpenzimet e veprimtarisë. Fluksi i tyre gjatë vitit 2005 është rritur me ritme të shpejta, duke ndikuar negativisht rezultatin neto të sistemit bankar. Ecuria e këtij treguesi gjatë gjithë vitit, por sidomos për tremujorin e fundit të vitit 2005, konfirmon zgjerimin në vazhdimësi të rrjetit të bankave, të materializuar në rritjen e numrit të degëve dhe agjencive, si edhe të numrit të punonjësve.

5. TREGUESIT E RENTABILITETIT

Në fund të vitit 2005, kthyeshmëria nga aktivet mesatare, RoAA në bazë vjetore, përlllogaritet 1.40 për qind. Treguesi në fjalë, flet për një përmirësim të ndjeshëm të RoAA në krahasim me vitin 2004, për shkak të rezultatit më të mirë financiar të bankave nga aktivitetet kryesore, pavarësisht nga shpenzimet e larta të aktivitetit si rrjedhojë e zgjerimit.

Edhe treguesi i kthimit nga kapitali aksioner mesatar, RoAE, ka ndjekur të njëjtën tendencë si treguesi i RoAA. Teknikisht, nga krahasimi i fundviteve 2004 dhe 2005, zhvillimet në këtë tregues shpjegohen kryesisht me rritjen pak më të shpejtë të rezultatit neto ndaj kapitalit mesatar aksioner, 29.2 për qind kundrejt 22.6 për qind. Ndërkohë, edhe pse kthyeshmëria ndaj kapitalit

aksioner rezulton e lartë, shpërndarja e dividendëve për aksionerët ka qenë e parëndësishme.

Tabelë 12. Tregues kryesorë të rentabilitetit në përqindje.

Treguesit	Dhjetor '05	Shtator '05	Dhjetor '04
RoAA	1.40	1.51	1.28
RoAE	22.24	24.51	21.10

Pavarësisht nga rënia, treguesi i RoAA shfaq një nivel të mirë dhe dukshëm më të lartë sesa vendet e zhvilluara. Besojmë se diferenca në fjalë, i atribuohet kryesisht mjedisit ende të pakonsoliduar të biznesit në Shqipëri, në krahasim me vendet e zhvilluara, gjë që përkthehet në një marzh më të lartë ndërmjetësimi.

Krahasuar me vendet e rajonit, treguesi i RoAA shfaqet në një nivel mesatar, referuar disa të dhënave që i përkasin vitit 2004 apo edhe më herët, për vende të tilla si Bullgaria, Rumania, FYROM, Serbi dhe Mal i Zi (SMZ). Më konkretisht, sjellja e RoAA është e krahasueshme me atë të Bullgarisë, më e ulët sesa RoAA e sistemit bankar në Rumani por më e lartë sesa në ish Republikat Jugosllave. Kjo dukuri identifikohet sidomos ndaj RoAA të sistemit bankar të Serbisë dhe Malit të Zi, ndoshta për shkak të problemeve specifike si edhe krizave sociale dhe ekonomiko-politike në këtë vend të rajonit.

Analiza sipas grupbankave vazhdon të identifikojë për të katër tremujorët e vitit 2005, bankat e G2 si bankat me nivel më të lartë të ROAA, me 2.6 përqind, pasuar nga bankat e G3, me 0.9 përqind dhe G1, me 0.5 përqind. Kthimi i lartë nga aktivet për kategorinë e bankave të G2, lidhet kryesisht me praninë e një portofoli të lartë të kredive ndaj totalit të aktiveve për bankat me peshë kryesore në këtë grup, madje dukshëm më të lartë se mesatarja e sistemit.

Rentabiliteti i sistemit bankar nga veprimtaria kryesore si edhe dinamika e ekuilibrit ndërmjet mbledhjes së burimeve për të cilat paguhet interes dhe investimit në aktive që fitojnë interesa, jepet në dy tabelat më poshtë:

Tabelë 13. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje.

Treguesit	Dhjetor '05	Shtator '05	Dhjetor '04
Të ardhura nga interesi / aktive mesatare që sjellin të ardhura (1)	6.81	6.78	6.96
Shpenzime për interesa / aktive mesatare që sjellin të ardhura (2)	3.08	3.23	3.88
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) – (2)]	3.73	3.55	3.08

Treguesi i NIM ka patur një tendencë në rritje gjatë vitit, duke shprehur në përgjithësi prirjen e bankave të sistemit për t'u orientuar drejt aktiveve më fitimprurëse brenda strukturës së aktiveve fitimprurëse. Analiza e komponenteve të treguesit të NIM tregon për një rënie të lehtë të komponentit të parë, ndërsa komponenti i dytë në tabelën më sipër, shfaq një ndryshim më të madh në kahun e rënies. Nëse do të marrim në konsideratë rritjen dhe parashikimet

për rritje të normave bazë të interesit, për zonat kryesore ekonomike në botë, ShBA dhe Eurozonë në kushtet kur: a) norma baze e interesit për lekun ka qenë e pandryshuar; b) bilanci i sistemit bankar karakterizohet nga një prani e madhe e usd dhe euro; dhe c) treguesit e tabelës më poshtë përlllogariten të pandryshuar; atëherë ecuria e komponentit të dytë, shpenzime për interesa në raport me aktive mesatare që sjellin interesa, tregon se bankat nuk kanë reaguar shpejt në rritjen e normave të interesave të pasiveve.

Treguesit	Dhjetor '05	Shtator '05	Dhjetor '04
Aktivet mesatare që sjellin të ardhura(1)	439,816.17	432,287.58	379,263.33
Pasivet mesatare që shkaktajnë shpenz. (2)	415,171.61	408,853.21	355,766.29
Aktivet mesatare(3)	471,250.99	463,602.12	400,080.92
(1)/(3)	0.93	0.93	0.95
(2)/(3)	0.88	0.88	0.89

Tabelë 14. Tregues të rentabilitetit në milionë lekë.

Tabela më sipër tregon për një qëndrueshmëri të aftësive të sistemit për të investuar në aktive, që fitojnë interesa dhe mbledhjes së burimeve për të cilat paguhen interesa. Ky fakt, shprehet në diferencën e pandryshuar ndërmjet dy treguesve të fundit, e cila vazhdon të qëndrojë rreth nivelit 0.05.

Treguesi i efikasitetit krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, konfirmon prirjen e theksuar të bankave për t'u zgjeruar më tej, çka manifestohet në shpenzime më të larta të veprimtarisë, por që bashkëshoqërohet dhe me rritje me ritme edhe më të shpejta të të ardhurave bruto. Këto zhvillime, dëshmojnë që ky tregues është përmirësuar, gjë që konfirmohet edhe nga përlllogaritja e treguesit mbi të dhëna kumulative vjetore, të cilat janë 0.50 dhe 0.53 respektivisht për vitet 2005 dhe 2004.

Treguesi	Dhjetor '05	Shtator '05	Dhjetor '04
Shpenzimet e veprimtarisë (1)	3,093.09	2,764.37	2,363.91
Të ardhura bruto të veprimtarisë ¹⁹ (2)	5,531.99	5,108.50	3,892.04
Efikasiteti (1)/(2)	0.56	0.54	0.61

Tabelë 15. Treguesi i efikasitetit (jo kumulative) në milionë lekë.

C. INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA

1. AKTIVITETI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA NË SHQIPËRI

- Siç përcaktohet nga standarde të ndryshme ndërkombëtare (UN, 1993; Eurostat, 1995; FMN, 2004)²⁰, institucionet financiare jobanka (IFJB) janë kompani ose institucione, që merren kryesisht me ndërmjetësim financiar ose aktivitete financiare ndihmëse, të lidhura ngushtë me ndërmjetësimin financiar, por që nuk klasifikohen si marrëse depozitash. Ato ndahen në ndërmjetës të tjerë financiarë, duke përfshirë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit.

2. KUADRI RREGULLATIV I INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA NË SHQIPËRI

Përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, pothuajse të gjitha IFJB-të e tjera, licencohen nga Banka e Shqipërisë. Një pjesë e tyre licencohen në mbështetje me rregulloren “Për licencimin e subjekteve jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 96, datë 26.11.2003. Në këtë rregullore nuk përfshihen zyrat e këmbimit valutor, licencimi i të cilave mbështetet në rregulloren “Për licencimin e zyrave të këmbimit valutor”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 65, datë 30.07.2003. Edhe shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre trajtohen veçmas nga kuadri rregullativ i Bankës së Shqipërisë. Ato licencohen në mbështetje të një rregulloreje të veçantë që është ajo “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre” e miratuar me vendim nr. 11, datë 27.02.2002, ndryshuar me vendimin nr. 09, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të rinisë licencimin dhe mbikëqyrjen e disa subjekteve jobanka, që më parë ishin përjashtuar nga ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”(konkretisht: fondacioni “Besa” dhe “Partneri Shqiptar në Mikrokredi (PSHM)”). Ndërkohë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare”, Banka e Shqipërisë nuk është më autoriteti licencues e rregullues i kompanisë së qirasë financiare “Tirana Leasing” sh.a. apo i kompanive të tilla që kryejnë vetëm aktivitetin e qirasë financiare.

3. MBIKËQYRJA E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA

Treguesit e gjendjes financiare të sektorit të institucioneve të tjera financiare, ndihmojnë për monitorimin dhe paralajmërimin për rreziqet që mund të sjellë ky sektor. Këta tregues duhet të sigurojnë informacion mbi përmasat e sektorit të korporatave të tjera financiare – në terma të peshës së aktiveve të institucioneve të tjera financiare, në totalin e aktiveve të sistemit financiar – për të krijuar idenë e rëndësisë së këtij sektori në sistem. Një tregues tjetër domethënës, që informon për rëndësinë e këtij sektori është pesha e aktiveve të tij mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB). Gjithashtu, rritja e shpejtë e kredithënies dhe akumulimi i shpejtë i aktiveve në përgjithësi, mund të tregojnë për problemet e mundshme të këtij sektori.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë licencon, rregullon e mbikëqyr aktivitetin e një pjese të IFJB-ve, konkretisht:

- Unioni Financiar i Tiranës sh.p.k.;
- Diners Club Albania sh.p.k.;
- Unioni Shqiptar i Shoqërive të Kursim-Kreditit;
- Unioni “Jehona”;
- Shoqëria “Credins” sh.a., Tiranë;
- Fondi i Financimit të Zonave Malore;
- AK- Invest sh.a.;
- Fondacioni “Besa”;

- Partneri Shqiptar në Mikrokredi (PSHM);
- Posta Shqiptare;
- Zyrat e këmbimit valutor;
- Shoqëritë e Kursim-Kreditit.

Sistemi raportues, i cili ka filluar të plotësohet dhe të raportohet në Bankën e Shqipërisë që nga tremujori i parë i vitit 2005, krijon mundësinë edhe për analizën nga jashtë të këtij sektori.

4. ANALIZË PËR PERIUDHËN MARS - DHJETOR 2005

Për arsye analize, fillimisht veçojmë nga IFJB-të e tjera, Shoqëritë e Kursim-Kreditit (SHKK-të). Këto të fundit, marrin depozita nga anëtarët e tyre, dhe në këtë kontekst konsiderohen si korporata të tjera depozituese, duke mos hyrë as në grupin e bankave por as në atë të subjekteve jobanka. Në vazhdim, në grupin e IFJB-ve të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë, mund të bëhet një ndarje e mëtejshme bazuar në ngjashmëritë e aktivitetit të tyre dhe definicioneve të standardeve, të përmendura më sipër. Kështu, disa kompani fokusohen në financimin e kompanive të tjera apo individëve, siç bëjnë fondacioni “Besa”; PSHM; Fondi i Financimit të Zonave Malore; dhe “Credins”, të cilat do t’i grupojmë si kompani financiare. Ndërsa pjesa tjetër e IFJB-ve janë ndihmës të tjerë financiarë (konkretisht: Unioni Financiar i Tiranës sh.p.k.; Diners Club Albania sh.p.k.; AK- Invest sh.a.; dhe Posta Shqiptare) të cilat ndihmojnë në ndërmjetësim, duke vepruar me mekanizmat e pagesave.

Do të përjashtohen nga analiza financiare zyrat e këmbimit, të cilat megjithëse licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, nuk raportojnë pranë Departamentit të Mbikëqyrjes apo Departamentit të Statistikave.

Për të analizuar rëndësinë e IFJB-ve dhe SHKK-ve në sistemin financiar, shohim fillimisht peshën e tyre në sistem: konkretisht peshën e aktiveve të tyre mbi ato të sistemit.

Tabelë 16. Aktivet e IFJB-ve²¹ e SHKK-ve.

Përshkrimi / Periudha	Mars 05	Qershor 05	Shtator 05	Dhjetor 05
Aktivitet e sistemit pa BSH (mln lekë)	473,424.1	499,373.2	516,771.5	521,028.9
Aktivitet e IFJB ²² (në mln lekë)	7,092.6 ⁵	9,949.1	10,095.1	10,829.9
Rritja e aktiveve të IFJB (në %)	-	40.3	1.5	7.3
Aktivitet e kompanive të sigurimit (mln lekë)	8,342.89	9,337.23	10,584.66	10,215.61
	-	11.9	13.4	(3.5)
Aktivitet e SHKK-ve (në mln lekë)	3,069.7	3,384.3	3,619.8	3,789.5
Rritja e aktiveve të SHKK-ve (në %)	-	10.2	7.0	4.7
Pesha e aktiveve të SHKK, IFJB dhe KS në sistem pa BSH (në %)	3.91	4.54	4.70	4.77
Pesha e aktiveve të bankave në sistem pa BSH (në %)	96.1	95.5	95.4	95.3

Siç shihet nga tabela, pesha e IFJB-ve bashkë me SHKK-të në totalin e aktiveve të sistemit financiar²³ është shumë e vogël, krahasuar me peshën që zënë në të bankat tregtare. Kështu, pesha e këtyre dy grupeve rezulton

respektivisht 1,2 dhe 0,5 për qind, ndërkohë që bankat e nivelit të dytë, përgjatë vitit 2005 përbënin mesatarisht 95.5 për qind të sistemit financiar. Edhe e vendosur mbi vlerën e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PBB), pesha e totalit të aktiveve të IFJB-ve dhe SHKK-ve në fundin e vitit 2005 ishte e parëndësishme, krahasuar me peshën e sistemit bankar mbi PBB për vitin 2005 (59,3 për qind).

Në pjesën më të madhe të tyre, aktivet e këtyre kompanive (IFJB dhe SHKK) përbëhen nga kredi të dhëna klientëve, individë apo kompani të tjera. Ndhmësit e tjerë financiarë nuk japin kredi, si rrjedhim analiza e cilësisë së portofolit të kredive ka kuptim vetëm për kompanitë financiare dhe SHKK-të.

Tabelë 17. Cilësia e aktiveve (dhjetor'05).

Treguesit	Kompanitë financiare	SHKK-të	Totali
Totali i kredive (në mln lekë)	5,174.4	2,966.4	8,140.8
Kredi gjithsej / totali aktiveve (në %)	80.3	78.3	79.5
Kredi me probleme (në mln lekë)	67.4	20.4	87.8
Kredi me probleme / totali i kredive	1.30	0.69	1.08
Humbje nga kreditë (në mln lekë)	0	4.0	4.0
Humbje nga kreditë / totali i kredive (në %)	0.00	0.14	0.05

Siç duket në tabelën më sipër, në fund të vitit 2005, kreditë zinin mesatarisht 80 për qind të aktiveve të IFJB-ve dhe SHKK-ve. Kreditë me probleme, kanë një peshë prej rreth 1.1 për qind në totalin e aktiveve të tyre, shumë më e ulët se niveli 8 për qind i përcaktuar nga kuadri rregullativ mbikëqyrës. Ndërkohë, humbjet nga kreditë janë të parëndësishme dhe i përkasin vetëm grupit të SHKK-ve.

Rezultati neto pozitiv i IFJB-ve për vitin 2005 është rreth 244 milionë lekë. Brenda këtij grupi, kompanitë financiare kanë rezultuar të gjitha me fitim për vitin, në një nivel total rezultati neto rreth 109.8 milionë lekë. Pjesën më të madhe të të ardhurave për këto kompani e përbëjnë të ardhurat nga interesat (rreth 72 për qind të të ardhurave totale) dhe konkretisht, ato nga kreditë. Ndhmësit e tjerë financiarë, kanë arritur një rezultat neto pozitiv prej rreth 134,3 milionë lekësh. Aktivitetet e ndryshme që kanë këto dy nëngrupe pasqyrohen dhe në burimet e ndryshme të të ardhurave. Kështu, për ndihmësit financiarë burimi kryesor i të ardhurave (rreth 86 për qind) kanë qenë të ardhurat nga komisionet. Rezultati neto i SHKK-ve, në fund të vitit, ishte rreth 41 milionë lekë dhe të ardhurat përbëheshin në pjesën më të madhe nga të ardhurat nga interesi i kredive.

DISA INFORMACIONE MBI AKORDIN E RI TË BAZELIT (BAZEL II) DHE MUNDËSINË E IMPLEMENTIMIT TË TIJ NË SHQIPËRI

1. AKORDI EKZISTUES I BAZELIT PËR KAPITALIN. PSE LINDI NEVOJA PËR NJË AKORD TË RI?²⁴

Me krijimin e Komitetit të Bazelit në vitin 1974, hynë në fuqi edhe një sërë standardesh ndërkombëtare për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen bankare. Në tërësinë e këtyre standardeve të njohura dhe të zbatueshme, do të veçonim Standartet e Kapitalit dhe Vlerësimit të tij, të njohura si Akordi i Kapitalit të Bazelit (në vijim Akordi). Ky akord u shpall zyrtarisht në korrik të vitit 1988 dhe njihet tashmë si Akordi i 1988-s. Akordi është në funksion të vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe sugjeron një standard minimal të kapitalit prej 8 për qind - kjo duke filluar nga fundi i vitit 1992. Deri më sot, ky akord është zbatuar ose më mirë të themi përshtatur²⁵, nga më shumë se 100 vende apo rajone në mbarë botën, ndonëse ai synonte fillimisht të zbatohet në bankat aktive në tregjet ndërkombëtare të vendeve anëtare²⁶. Rreth 10 vjet më vonë, u propozua një kuadër i ri i mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili u shpall zyrtarisht për diskutim nga Komiteti i Bazelit, në qershor të vitit 1999. Sipas Komitetit të Bazelit, kuadri i ri i quajtur Akordi i Ri i Kapitalit (Bazel II) do të zëvendësojë Akordin aktual të vitit 1988.

Në vitin 1988, kur u shpall Akordi, kapitali i bankave dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit përgjithësisht u rritën, madje në mënyrë të konsiderueshme. Kështu, bankat me nivele të kapitalit nën ato minimale të kërkuara, i rritën raportet e kapitalit më shumë se ato banka me nivele të kënaqshme të kapitalit. Është fakt që edhe me disa ndryshime të tij, Akordi nuk ka penguar zhvillimet e tregut bankar dhe nuk mund të shihet i shkëputur nga zhvillimet e rëndësishme financiare, që ndikojnë në veprimtarinë e bankave, të cilat po prezantojnë një profil rreziku të ndryshëm nga ai çfarë përshkruan Akordi ekzistues. Siç dihet, Akordi ekzistues fokuson vetëm rrezikun e kreditit, por tashmë është i njohur fakti që rreziku i kreditit nuk është më i vetmi me të cilin përballen bankat sot. Përveç rrezikut të kreditit, bankat sot përballen në veprimtarinë e tyre të përditshme me një sërë rreziqesh të tjera si i tregut (i kursit të këmbimit, i normave të interesit), i likuiditetit, operacional, ligjor, i reputacionit dhe ai strategjik. Po kështu, praktikat e administrimit të rrezikut, duke kaluar gjithashtu përmes disa ndryshimeve kritike, çuan në zhvillimin dhe përdorimin gjithnjë në rritje të modeleve të tilla të sofistikuar si Value at Risk, CreditMetrics, CreditRisk etj., të cilat po preferohen në shkallë gjithnjë e më të gjerë.

Për më tepër, dy dekadat e kaluara kanë evidentuar një përshpejtim të ritmeve të globalizimit dhe liberalizimit financiar. Këtyre ritmeve i shtohet një tërësi instrumentesh financiare të reja, të cilat vazhdojnë të shtohen ditë-ditës. Titullizimi i aktiveve, instrumentet derivative, financat e strukturuara dhe zbatimet e teknikave fizike financiare, kanë luajtur rolin e tyre në diversifikimin

e të ardhurave dhe në monitorimin e rrezikut. Disa prej tyre, fillimisht kanë lindur nga nevoja për monitorimin e rrezikut dhe gradualisht janë shndërruar në gjenerues të tij. Si rrjedhojë, gjendja financiare e bankave bëhet pothuaj e paqartë, sa më të shumta të jenë produktet e komplikuara hibride financiare që ato përdorin. Si rezultat, një vlerë gjithnjë e më e madhe transaksionesh evidentohet jashtë bilancit.

Po kështu, në nivel global, kufijtë tradicionalë midis veprimtarisë bankare dhe asaj të letrave me vlerë apo të sigurimit, shpesh shfaqen të zbehtë. Jo rrallë bankat shesin siguracione, kompanitë e sigurimit ofrojnë mbrojtje financiare duke përdorur instrumentet e tregut të kapitaleve dhe shoqëritë e sigurimit ofrojnë shërbime të administrimit të *cash-it*, duke konkurruar kështu depozitat bankare. Gjithashtu, konsolidimi i sektorit financiar që diktohet nga rritja e kërkesës së klientëve për shërbime financiare të integruara dhe rritja e presionit të aksionerëve për të shtuar fitimet, po bëhet gjithnjë e më evident nëpërmjet shkrirjeve dhe bashkimeve, aleancave strategjike dhe investimit të kapitaleve të përbashkëta në institucionet financiare në botë.

Përparimi i teknologjisë së bashku me zhvillimin e konsiderueshëm të ekonomisë botërore, kanë rritur shumë mbështetjen e bankave në sistemet kompjuterike, internetin, komunikimin nëpërmjet satelitit etj.. Ndryshimet e teknologjisë në këto fusha, tashmë po marrin në konsideratë edhe mënyrën se si operojnë dhe administrohen bankat, transformimin dhe funksionimin e tregjeve financiare, duke sjellë kështu mënyra apo modele të reja të rrjedhjes (transferimit) së fondeve dhe duke krijuar konfigurime të reja të kuadrit operacional dhe administrues të bankave.

Në të njëjtën kohë, veprimtaria mbikëqyrëse dhe autoritetet përkatëse po njohin ndryshime të vazhdueshme, në përgjigje të zhvillimeve në tregjet financiare. Rritja e ndërkombëtarizimit dhe globalizimit të tregjeve financiare dhe bankare, dikton nevojën e harmonizimit të veprimtarisë mbikëqyrëse dhe konvergimit të metodologjive përkatëse. Theksi mbetet në mbikëqyrjen e veprimtarisë bankare, për vetë rëndësinë e saj në zhvillimin ekonomik dhe mirëqënien e publikut.

Zhvillimet e mësipërme evidentuan një sërë mangësish të Akordit, të cilat kulmojnë me mungesën e fleksibilitetit të tij në matjen e rreziqeve.

2. BAZEL II, KUNDREJT AKORDIT TË 1988-S

Bazel II përbëhet nga tre shtylla: shtylla e parë- kërkesa minimale për kapital, shtylla e dytë - roli mbikëqyrës dhe shtylla e tretë – disiplina e tregut. Pa u ndalur në veçanti në këto tre shtylla të trajtuara në raportet tona të mëparshme, do të fokusojmë në mënyrë të përmbledhur çfarë sjell Akordi i Ri përkundrejt atij të 1988-s dhe zbatimi i tij në vendet në zhvillim, e ndikimet e tij.

Ndryshimet kryesore mes Bazel II dhe Akordit të 1988-s, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Akordi i 1988	Bazel II
Struktura dhe përmbajtja	Kërkesa e vetme për kapitalin minimal	Tre shtylla: kërkesa për kapitalin minimal, rishikimi i procesit të mbikëqyrjes dhe disiplina e tregut
Metodologjia	Standarde përshkruese	Standarde përshkruese më opsionale, metodologji të brendshme ose një kombinim i të dyjave, me modele më shumë të karakterit teknik dhe më të sofistikuar që nxisin një administrim më të mirë të rrezikut
Fleksibiliteti në zbatim	Një metodë zbatohet (përshtatet) për të gjitha llojet e rrezikut	Metoda më shumë diskrete dhe dinamike.
Ndjeshmëria ndaj rrezikut	Jo shumë specifike	Më e ndjeshme ndaj rrezikut
Monitorimi i rrezikut	Monitoron rrezikun e kreditit dhe atë të tregut	Monitoron një kuadër të plotë të rreziqeve
Ponderimi i aktiveve me rrezikun	Aktivet ponderohen me 0-100 për qind rrezik, dhe iu jepet preferencë vendeve anëtare të OECD-së	Aktivet ponderohen me 0-150 për qind rrezik ose edhe më shumë se 150 për qind, nuk bëhet asnjë diskriminim madje merret në konsideratë edhe klasifikimi i brendshëm dhe i jashtëm
Diferencimi i rreziqeve	Bëhet mekanikisht	Bëhet një diferencim më i madh madje duke marrë në konsideratë dhe praktikatat e tregut
Përqëndrimi i rreziqeve	Nuk e trajton	Bën një modifikim (rregullim) të vogël
Teknikat e zbutjes (mbulimit) së rrezikut	Vetëm kolaterali dhe garancia	Konsideron më shumë teknika të tilla si kolaterali, garancia, derivativët për kreditin, pozicioni neto
Titullizimi i aktiveve	Nuk e trajton	E trajton në mënyrë të veçantë
Rregullimi i mospërputhjeve	Nuk e trajton	Trajton kryesisht mospërputhjet e aktiv-pasiveve sipas maturitetit dhe monedhës
Kërkesat mbikëqyrëse	Nuk i trajton	Parashikon kërkesa të shumta, të përgjithshme dhe specifike, si paraprake dhe në vazhdimësi
Kontrolli i brendshëm	Nuk e trajton	Thekson me forcë kontrollin e brendshëm
Transparenca	Nuk e trajton	Kërkon transparencë të lartë
Konsolidimi	Konsolidimi individual	Konsolidimi sipas grupbankave (tier group) duke përfshirë edhe shoqëritë që janë aksionere në banka

3. ZBATIMI I BAZEL II NË VENDET NË ZHVILLIM DHE NDIKIMET E TIJ (TË PËRGJITHSHME)

Në vendet në zhvillim, Bazel II pritet të ofrojë një nxitje të fortë për fuqizimin e mbikëqyrjes bankare, ndërkohë që vetë bankat do të jenë më të sofistikuar në administrimin e rrezikut.

Në fakt, duke iu referuar disa parashikimeve konkrete të tij, Bazel II përfaqëson një standard i cili paraqet disa vështirësi në zbatim. Për shembull, mungesa e agjencive vendase të klasifikimit ose zhvillimi i ulët i tyre në vendet në zhvillim, do të thotë që shumë rreziqe të brendshme të paklasifikuara të ponderohen me 100 për qind. Megjithëse mund të ketë elemente të reja shtesë të ndjeshmërisë së rrezikut, si kërkesa më të larta për kapital shtesë, për kreditë që iu ka kaluar afati i kthimit ose kërkesa për kapital shtesë për të gjitha angazhimet e anulueshme pa kusht, ky element do të sillte si pasojë uljen e ndjeshmërisë ndaj rrezikut në standardin e ri, si edhe mund të rezultonte në kushte të pabarabarta të konkurrenceës midis bankave vendase dhe atyre të huaja. Kjo, kur vendosja e pjesës më të madhe të rreziqeve të brendshme në kategorinë e paklasifikuar, do të bënte që huamarrësit e klasifikuar më mirë në këto vende, të merrnin hua me kosto më të ulët nga bankat ndërkombëtare, krahasuar me ato vendase.

Këto interpretime dhe të tjera, kanë ngritur nevojën për një standard të ndërmjetëm midis Akordit të 1988 dhe Bazel II, në mënyrë që bankat vendase në ekonomitë në zhvillim të mund të përfitojnë nga Bazel II, me kosto të përballueshme. Kjo do të thotë së pari, vendeve joanëtare të Komitetit të Bazelit të mos iu kërkohej e detyruar përshtatja e standardeve të reja, dhe vendet që preferojnë të përdorin Bazel I janë të lira të vazhdojnë në këtë mënyrë. Kështu, ekonomitë në tranzicion nuk duhet të penalizohen nëse nuk përshtasin Bazel II, në periudhën afatshkurtër. Dhe së dyti, në qoftë se Bazel II ka për qëllim përmirësimin rregullator, atëherë do të shihej me tepër interes zbatimi i këtij standardi më të lartë. Kjo do t'i nxishte këto vende, në zhvillimin e industrisë së tyre të klasifikimit dhe në përmirësimin e sistemeve të tyre financiare.

KUTI 1: OPINIONE PARAPRAKE NË LIDHJE ME NDRYSHIMET E MUNDSHME QË MUND T'I BËHEN KUADRIT TONË RREGULLATOR SIPAS METODËS STANDARDE TË RREZIKUT TË KREDITIT.

Opinionet e mëposhtme për disa ndryshime të mundshme në kuadrin rregullator ekzistues, marrin shkas nga supozimi i arsyeshëm, që prezantimi i një numri më të madh të kategorive të rrezikut të kreditit, do të rrisë ndjeshmërinë ndaj këtij rreziku dhe rrjedhimisht, do të përafrojë kërkesat rregullatore për kapital me natyrën e rrezikut, që bankat ndeshin në veprimtarinë e tyre. Gjithsesi, jetësimi i këtij parimi duhet të bashkëshoqërohet natyrshëm me pasojat që mund të ketë një rritje e paarsyeshme e kategorive të rrezikut të kreditit, në ngarkesën operacionale të bankave, të cilat do të jenë subjekte.

Opinionet tona paraqiten në dy grupe: grupi i parë sjell matricën e ponderimit të rrezikut të kredisë për qeveritë (sovrantin) dhe bankat qendrore, bankat, korporatat dhe grupi i dytë, sjell trajtimin e portofolit të huave për individët (duke përjashtuar huatë për banesa), biznesin e vogël si dhe në mënyrë të veçantë, për banesat.

I. METODA STANDARDE – MATRICA E RREZIKUT TË KREDISË (SOVRANI, BANKAT DHE KORPORATAT)

Më poshtë paraqitet matrica e ponderimit të pretendimeve ndaj sovranit, bankave dhe korporatave. Në këtë rast, në krahasim me modelin aktual, shtohet një kategori me ponderim 150 për qind dhe korporatat kanë mundësi tashmë të marrin jo vetëm një ponderim të paracaktuar prej 100 për qind, por dhe një ponderim që varion nga 20 për qind deri në 150 për qind. Gjithashtu, në këtë model, një rol të rëndësishëm në përcaktimin e ponderimeve ndaj ekspozimeve në fjalë luajnë, të paktën, agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit (ECA) të përcaktuara sipas BIS. Në përdorimin e këtij koncepti, duhet patur parasysh që vlerësimet e kryera nga ECA për një organizatë, për shembull, bankë brenda një grupi/holding, nuk mund të përdoren për të përcaktuar ponderimet e organizatave të tjera brenda grupit.

Përfshirja e ECA në formatimin e kuadrit rregullator, përbën një risi e cila nuk është e parakohshme, nxit zhvillimin e mëtejshëm të tregut financiar në Shqipëri, rrit disiplinën e tregut, iu ofron korporatave një mundësi reale për të rritur levën financiare me kosto më të ulët dhe u paraprin zhvillimeve të mëtejshme në industrinë financiare, pa harruar tentativat për një përafrim sa më të mirë të kapitalit rregullator me atë ekonomik. Për çdo rast, marrja në konsideratë e vlerësimeve do të kishte një efekt pozitiv në uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar, një përfitim i dëshiruar për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë.

Tabelë 1. Matrica e ponderimeve të pretendimeve ndaj sovranit, bankave dhe korporatave

Vlerësimi i rrezikut të kredisë	AAA to AA-	A+ to A-	BBB+ to BBB-	BB+ to B-	Më pak se B-	E pavlerësuar
Pesha e rrezikut (RË) për sovranin/banka qendrore (%) ²⁷	0	20	50	100	150	100
RË për bankat (%) (Opsioni 1) ²⁸	20	50	100	100	150	100
RË për bankat (%) (Opsioni 2) ²⁹	20	50	50	100	150	50
Vlerësimi i rrezikut të kredisë	AAA to AA-	A+ to A-	BBB+ to BB-	Me pak se BB-		
RË për korporatat (%) ³⁰	20	50	100	150	150	100

II. METODA STANDARDE – RREZIKU I KREDISË PËR PORTOFOLIN E HUAVE ME PAKICË DHE I HUAVE PËR SHTËPI

1. Sipas propozimeve të Bazelit, pretendimet ndaj huave që plotësojnë kriteret si më poshtë, duhet të konsiderohen portofol huash me pakicë për qëllime të llogaritjes së kapitalit rregullator. Ekspozimet e përfshira në këtë portofol mund të ponderohen me një peshë 75 për qind, përveçse kur ato plotësojnë kriteret e huave që iu ka kaluar afati mbi 90 ditë.

Kriteret e përcaktuara vijojnë si më poshtë:


- Ekspozimi është ndaj një individi ose ndaj një biznesi të vogël.
- Ekspozimi ka për shembull formën e kartave të kreditit, huave për automjete, kontrata qiraje, hua për shkollim apo çfarëdolloj financimi personal.
- Portofoli është i diversifikuar në mënyrë të tillë që të kënaqë kërkesat e rregullatorëve. Për shembull, një diversifikim i kënaqshëm mund të ishte vendosja e një kufiri numerik në mënyrë të tillë, që asnjë ekspozim mbi baza të konsoliduara/agreguara të mos kalojë 0.2 për qind të portofolit të huave me pakicë.
- Maksimumi i ekspozimit ndaj një kundërpattie, gjithashtu të mos kalojë një nivel të caktuar, për shembull 100 mijë euro apo kundravlehtë në çdo monedhë tjetër.

2. Huatë për shtëpi, përkufizimi i të cilave tashmë ekziston në kuadrin tonë rregullator dhe që mund të përmirësohet më tej, mund të ponderohet edhe me një peshë prej 35 për qind. Aktualisht, pesha që aplikohet është 50 për qind. Pra, në varësi të gjykimit të autoritetit rregullator vendas, Komiteti i Bazelit propozon edhe një normë të dytë ponderimi, e cila e shtrin parimin e diskriminimit të rrezikut dhe mënjanimimit të trajtimit arbitrar të huave, nga pikëpamja e kërkesave për kapital edhe në këtë kategori huash, duke bërë diferencimin në këtë rast ndërmjet huave për shtëpi me rrezik më të ulët dhe më të lartë. Në mënyrë që brenda portofolit të huave për shtëpi, të dallojmë ato që kanë më pak rrezik, duhet që të vendosim disa kritere parimore, të cilat mund të kenë të bëjnë me elementet e mëposhtme:

- Prania e një marzhi substancial kolaterali mbi huanë (LTV ratio)³¹.
- Vlerësime strikte dhe periodike të kolateralit.
- Kolaterali është i gradës së parë apo të dytë.
- Afati i maturimit të huasë.
- Lloji i monedhës.
- Norma e interesit fikse apo e ndryshueshme.

Tre kriteret e fundit mund të shtohen sepse janë parametra që ndikojnë në ecurinë e huasë dhe mënyrën sesi mund të ndikohen bankat, direkt apo indirekt. Për shembull, nga pikëpamja e ekspozimit direkt dhe stabilitetit financiar, do të sugjerohet që ato hua për shtëpi të cilat për shembull kanë një maturim më të vogël se 10 vjet, kanë normë interesi të ndryshueshme dhe akordohen në monedhë vendase, të kualifikoheshin për një peshë prej 35 për qind (me kusht që të plotësohen njëherazi edhe kriteret e tjera). Kjo e fundit mbështetet të paktën mbi dy faktorë: së pari, tregjet financiare në Shqipëri janë të pazhvilluara siç duhet dhe për rrjedhojë, edhe kurba e normave të interesit në lekë është e vështirë të ndërtohet për periudha më të gjata sesa dy vjet. Së dyti, burimet e bankave në lekë (qoftë edhe në valutë) janë me gjatësi jo më të madhe sesa dy vjet, duke i ekspozuar bankat në mënyrë direkte ndaj një rreziku potencial likuiditeti dhe të normës së interesit, nëse kredia do të ishte me një interes fikse për gjithë jetëgjatësinë e saj.

ANEKS 1. STRUKTURA E DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES
(DATË 31 DHJETOR 2005)



ANEKS 2. NIVELI I AKTIVEVE, I DEPOZITAVE DHE I KREDIVE NË DHJETOR 2005 (MILIONË LEKË)

Nr.	Bankat	Aktive	Depozita	Kredi
1	Banka Raiffeisen	202,517.39	191,057.27	16,895.78
2	Banka Kombëtare Tregtare	61,136.98	56,510.40	13,078.38
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	4,079.84	2,545.96	1,620.72
4	Banka Italo Shqiptare	19,332.46	16,143.97	5,230.61
5	Banka Italiane e Zhvillimit	1,282.34	238.02	6.24
6	Banka Tirana	40,368.43	33,563.78	16,363.38
7	Banka Kombëtare e Greqisë, Dega Tiranë	12,621.03	8,364.46	8,153.48
8	Banka Ndërkombëtare Tregtare	3,118.59	2,179.82	1,501.55
9	Dega në Tiranë e Bankës Alfa	28,565.75	21,644.93	13,329.29
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	55,779.97	46,799.72	20,992.85
11	Banka ProCredit	24,029.70	20,454.45	10,210.34
12	Dega e Bankës së Parë të Investimeve	2,546.08	710.39	120.46
13	Banka Emporiki	7,532.81	3,922.65	5,128.19
14	Banka e Kreditit të Shqipërisë	1,613.34	783.79	384.68
15	Banka Credins	16,727.35	14,434.06	6,174.05
16	Banka Popullore	15,309.44	13,606.76	7,866.37
17	Banka Union (e sapolicencuar)			
	TOTALI	496,561.49	432,960.41	127,056.37

ANEKS 3. NUMRI I DEGËVE, I AGJENCIVE DHE I PUNONJËSVE PËR ÇDO BANKË³²

Nr.	Bankat	Nr.degëve	Nr.agjencive	Nr.punonjësve
1	Banka Raiffeisen	14	83	1 103
2	Banka Kombëtare Tregtare	20	5	375
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	3		51
4	Banka Italo Shqiptare		5	77
5	Banka Italiane e Zhvillimit	1		14
6	Banka Tirana	25	2	349
7	Banka Kombëtare e Greqisë, Dega Tiranë		6	92
8	Banka Ndërkombëtare Tregtare	4		54
9	Dega në Tiranë e Bankës Alfa	8	1	81
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	5	7	358
11	Banka ProCredit	16		489
12	Dega e Bankës së Parë të Investimeve		2	27
13	Banka Emporiki	2	1	60
14	Banka e Kreditit të Shqipërisë		1	30
15	Banka Credins	7	2	113
16	Banka Popullore	22		206
17	Banka Union (e sapolicencuar)			
	TOTALI	127	115	3 479

ANEKS 4. AKTIVET DHE PASIVET E SISTEMIT BANKAR (DHJETOR 2005)

KODI	PËRSHKRIMI	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005
1	TOTALI I AKTIVEVE	426,440.34	496,561.49
11	VEPRIMET ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	308,914.15	292,217.33
111	Mjete monetare	9,931.96	10,333.77
112	Marredhenie me banken qendrore	37,056.26	46,128.38
1121	Rezerva te detyrueshme në bankën qendrore	35,480.11	41,662.40
1122	Të tjera	1,576.15	4,465.98
113	Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore	195,379.64	175,380.40
1131	Bono thesari	195,379.64	175,380.40
1132	Bono të tjera të pranueshme për rifinancim	0	0
1133	Fonde rezerve për zhvlerësimin e bonove të përshtatshme për rifinancim nga BQ	0	0
114	Marredhënie me bankat, institutet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	66,546.29	60,374.78
1141	Llogari rrjedhëse	3,019.62	3,197.31
1142	Depozita në banka, institucione krediti dhe institucionet të tjera financiare	59,905.22	53,679.02
1143	Hua	1,814.72	2,599.09
1144	Të tjera	1,806.73	899.35
13	VEPRIMET ME KLIENTËT (Bruto)	69,798.94	127,056.37
131	Hua dhënë sektorit privat dhe individëve	64,824.71	118,071.40
1311	Hua afatshkurtër	18,712.19	33,313.57
1312	Hua afatmesme	24,560.70	38,818.74
1313	Hua afatgjatë	10,983.40	29,346.71
